



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.878 prot.

Tiranë, më 05.05. 2026

V E N D I M

Nr. 115, datë 05.05. 2026

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi² është regjistruar ankesa nr. 133 Regj, datë 30.05.2025, e paraqitur nga znj.E. D , kundër Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH), me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve filozofike*.”

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pala ankuese parashton:

“Qnhem E. D , jam mësuese matematike-fizike në fshatin Bashaj në qytetin e Vlorës. Prej vitit 2019, jam kryetare e Seksionit Sindikal për Bashkinë Selenicë. Në shumicën e rasteve jam atakuar për problematikat që kam ngritur apo informacionet që kam kërkuar mbi të drejtat e mësuesve, llogaridhënien për veprimtarinë tonë si organizatë. Kam patur bashkëpunime shumë të mira dhe zgjidhje me Avokatin e Popullit, Qarkun Vlorë dhe Bashkinë, me ZVAP Selenicë.

Përmbledhtazi po parashtoj rastet sidomos nga 2023 e deri më sot që tregojnë se diskriminimi është i hapur:

- 1. Kam kërkuar dy herë, përmes kërkesës me shkrim, informacion mbi transparencën financiare të Anëtarëve të kryesisë, sipas Statutit të FSASH. Jam shpërfillur dhe nuk më është dhënë asnjë informacion mbi kërkesën time. Pra, pas kërkesave të mia, jam bullizuar më shumë.*

¹ Në vijim do t’i referohemi me LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me Komisioneri.

2. Kam kërkuar dy herë, përmes kërkesës me shkrim, informacion se cilat janë masat e marra nga Komisioni i Etikës për shkelje të etikës ndaj figurës time nga kryetarja e një ZVAP-je tjetër znj. E. Z.
3. Kam ngritur problematika të ndryshme së bashku me mësuesit, me anë të një letër këmbimi me shkresa zyrtare MAZ, Av.Popullit, Ministria e Financave, Bashkia Selenicë, ZVAP Selenicë, FSASH për transportin e mësuesve me vlerën reale në përditshmërinë tonë, leja e zakonshme e cila është 56 ditë punë dhe nuk është zbatuar asnjëherë sepse mësuesit thirren gjatë periudhës së lejes për problematika dhe arsye të ndryshme, për problematika të mjetit të transportit në zona të largëta, për kriteret dhe vazhdimësia e procesit të kualifikimit të mësuesve, për hedhjen e provimit të shtetit, lidhja e kontratës kolektive me Bashkinë Selenicë për punonjësit në IA nën juridiksionin e bashkisë, në grupin ehatsapp dhe në mbledhjen e këshillit drejtues, për të cilat jam evidentuar si një njeri që i bëj për tu dukur apo për përfitim posti.
4. Ofendimt e shkruajtura nga anëtarë të grupit si spiune, them gënjeshtër, broçkulla, merrem me thashetheme.
5. Më datë 27.04.2025 pata një komunikim me sms me grupin e punës i ngritur për të ndihmuar Seksionet Sindikale, më njofton se do të vinin në Vlorë për takim me mua por unë i njoftova se duhet të ishte kryetari i ri z.Shpëtim Brahaj në takimin e parë me kryetarët e shkollave për ti dëgjuar direkt por erdhi grupi i punës z.B.Sh dhe z.S. K në orën 2:30. Për shkak të largësisë nga shkollat për në qendrën e Vlorës, sugjeroj që takimi të zhvillohej në orën 2:30 pas pune. Grupi i punës, pa më njoftuar mua, shkojnë në Selenicë dhe zhvillojnë takime në shkollën e mesme "Hajredin Beqari", ku takojnë drejtoreshën dhe kryetaren e Këshillit të Shkollës, duke më anashkaluar mua. Madje, në takimin që patëm po atë ditë në Vlorë, nuk më informojnë për takimet që kanë zhvilluar në Selenicë, por kjo u konfirmua nga kryetarja e sindikatës së shkollës, e cila më vuri në dijeni për këtë me anë të një sms. Kjo është mungesë respekti ndaj personit tim.
6. Kërkesa ime dhe e Kryetarëve të shkollave për protestën e 1 Majit në takimin që zhvilluam dhe mesazhi të cilin e hodha në grup që solli reagimet, ofendimet, diskriminimin për të cilën marr vërejtje vetëm unë ndërsa të tjerët jo, për sjellje të papërshtatshme dhe shkelje të etikës në komunikimin publik. (si mund të jetë grupi i ehatsapp komunikim publik)
Në takimin e Vlorës, kryetarët e këshillave sindikale të Selenicës (që janë edhe anëtarë të seksionit Sindikal Selenicë) u kërkuan përfaqësuesve të grupit të punës të organizohej diçka për 1 Maj. Këtë gjë e kërkoja edhe vetë. Me 1 Maj, e ngrita neglizhencën e FSASH për të mos organizuar asnjë veprimtari sindikale për Ditën e Punëtorëve. Jo vetëm që nga ana e kryetarit nuk pati asnjë prononcim, por më sulmuan njëri pas tjetrit të njëjtët persona (anëtarë të KD), të cilët bullizojnë përherë. Nuk pati asnjë reagim nga Kryetari ndaj tyre.
Fill pas sulmeve dhe bullizmit me fjalë fyese, Sekretari i Përgjithshëm hedh në grupin e ehatsapp njoftimin se Kryesia e Federatës më jep masë disiplinore, duke shkelur statutin e federatës, me motivacionin për prishje të qetësisë së anëtarëve të KD, në ditë pushimi.
Pas këtij njoftimi Sekretari i Përgjithshëm njofton mbylljen e komenteve të grupit nga anëtarët e KD për ditët e pushimit dhe orarit zyrtar. Që nga data 1 Maj, grupi është hapur sot, më datë 29.05.2025, por duke hequr të drejtat e anëtarëve të KD të shkruajnë e komentojnë.

7. *Grupi i hapur në ehatsapp është për të paraqitur dhe diskutuar problematika dhe jo të të mbyllin gojën sepse u intereson. Kjo faqe i shërben seksioneve sindikale të federatës për të transmetuar problemikat, shqetësimet dhe veprimtarinë e sindikatës, ku veprimtaria duhet të jetë e bazuar në statut dhe jo në veprimtari private me imponim.”*

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”,* ndërsa në nenin 12, *“Ndalimi i diskriminimit”,* pika 1, gema “ç”, të po këtij ligji, parashikohet: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfutur nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.”* Duke përdorur termin *“ndër të tjera”*, situatat e listuara nga neni 12, pika 1, janë orientuese dhe mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit, sipas LMD ofrohet në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me të drejtën për punësim dhe profesion dhe jo vetëm për përcaktimet e bëra nga neni 12.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD-së, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në kuadër të shqyrtimit paraprak të ankesës, pas shqyrtimit të parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituara nga ana e ankueses, me emailin e datës 13.06.2025, palës ankuese iu kërkua informacion plotësues në lidhje me ankesën, ndër të tjera në lidhje me çështjet e mëposhtme:
 - Shpjegime në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit "bindjet filozofike".
 - Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, pala ankuese pretendon se "është atakuar për problematikat që ka ngritur apo informacionet që ka kërkuar mbi të drejtat e mësuesve, llogaridhënien për veprimtarinë e organizatës". Në lidhje me këto pretendime, palës ankuese iu kërkua që të depozitonve dokumentacionin provues.
2. Me shkresën e administruar pranë Komisionerit me nr. 856/1 prot datë 27.06.2025, pala ankuese ka depozituar dokumentacionit plotësues për ankesën.
3. Në vijim të paraqitjes së ankesës, pala ankuese nëpërmjet *e-mailit* të datës 14.07.2025, ka informuar Komisionerin se situata e saj në sindikatë është bërë edhe më e rëndë. Në vijim nëpërmjet *e-mailit* të datës 15.07.2025, ankuesja ndër të tjera parashtron se:

Në datë 27.06.2025 është njoftuar se në zyrat qendrore të FSASH në Tiranë do të zhvillohej një takim me Komisionin e Etikës. Në takim ishte prezent Sekretari i Përgjithshëm z. S.K, z.B. Sh, Sekretar Organizativ, 3 anëtarët e Komisionit të Etikës nga 5 që janë z. R. Gj, kryetar, z.I. Th, sekretar, z.E. M anëtar dhe znj.B. Z, e cila nuk informoi në lidhje me praninë e saj. Ankuesja pretendon se, gjatë këtij takimi është përballur me akuza të pavërteta dhe se në përfundim të takimit nuk i është dhënë kopje e dokumentacionit (raportit dhe protokollit) por vetëm një fotokopje e thjeshtë.

Më pas, ankuesja deklaroi se ka marrë një njoftim për mbledhje me Këshillin Drejtues në datën 04.07.2025. Ankuesja pretendon se gjatë takimit nuk është lejuar që të paraqesë faktet e saj përpara Këshillit Drejtues.

Ankuesja shprehet se nga të dy mbledhjet e zhvilluara nuk i është komunikuar asnjë dokument zyrtar i firmosur, kjo në shkelje të hapur të ligjit dhe hiqet nga grupi ehatsapp-it pa vendim.

1. Me shkresën nr. 856/2 prot datë 28.07.2025, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion në lidhje me ankesën nga FSASH.

2. Me shkresën nr.146 prot., datë 08.08.2025, ka kthyer përgjigje FSASH, duke parashtruar :

Znj. E. D , ish Kryetare e Seksionit Sindikal të FSASH, NJVA Selenicë, deri në datë 04.07.2025, në asnjë rast dhe për asnjë arsye, nuk është atakuar për problemet që ka ngritur në Këshillin Drejtues të FSASH, aq më pak të jetë diskriminuar për bindjet filozofike që ajo pretendon se ka:

Në një status të znj. D. , në 11 Tetor 2024, ajo komenton për zhvillimet demokratike të Kongresit të 9. Me këtë status ajo akuzon strukturat e niveleve të ndryshme, të zgjedhurit, duke vënë në dyshim mënyrën demokratike të zgjedhjeve në Kongresin e 9 të FSASH:

E. D : “ *Së pari ndjesë për orën që po shkruaj sepse ditë e ngarkuar. mirëmbërëma. Njihem si njëri që ti them gjërat në sy dhe nuk ka frikë nga asgjë dhe nga askush, në pamundësi po shkruaj. Cilido mund të kërkojë përballje ashtu siç kam kërkuar dhe kërkoj edhe unë në vazhdim. Dua të bëj një përmbledhje të këtij kongresi, i cili është pothuajse i njëjtë me 8-tën por ky 9-ta pak më mirë i përpunuar, kurse për mënyrën e pabesisë është i njëjtë. E çuditshme për mua: tërheqja e kandidatit në minutën e fundit sepse mbajti edhe referatin kaq mirë të formuluar me shumë arritje më duket ktheu qokën e kongresit të 8-të, mosreagimi i dy kolegeve kur iu përmend emri për seksionet, heshtja e delegatëve kur na tregojnë gjera çfarë do bëjmë e përfitojmë kur ne duam gjera konkrete të prekshme. Vura re se gjojnë oferatat si mbajtja e vendit kryetar/e sipas anëtarësisë, por harroni se u votojnë mësuesit o kryetarë dhe kryetare, dikush do post, dikush karrierë, dikush do të mbajë vendin që ka. Sot duhet të ishte njëra nga ne e përzgjedhur sepse boll drejtuan meshkujt, edhe ne dimë të drejtojmë sepse arritjet duhet të vlerësohen për një kohë të shkurtër dhe jo për një kohë të gjatë. Vura re që delegatet femra nuk e përkrahën një femër, nuk e vlerësuan sepse lufta brenda llojit është më e ashpër, merrni pjesë edhe në trajnime si ta përkrahim dhe vlerësojmë femrën....U bënë akuza kundrejt kryetarëve, sindikatës, shpenzimeve, kur sot në sallë ishin vetë përfituesit dhe di që është kërkuar transparenca e përfitimeve të secilit anëtar të kryesisë, përse ky dokument nuk ndodhet në dorën e çdo anëtari të KD për transparencë gjithmonë....unë e dua këtë transparencë. E dini pse nuk u dha, sepse admiruesit për kryetar janë pjesë e saj por edhe të tjerë që kanë pasur forma dhe mënyra që mund ti denonconim edhe më parë por nuk e kanë bërë sepse janë pjesë e përfitimeve dhe pse pikërisht sot???? Por koha është treguesi më i mirë, kush mban dhe do e mbaj fytyrën dhe kush maskën??? Nuk e di se sa të qetë jeni ju që shitët “shpirtin” ama them drejtësia hyjnore ua përktheftë”*

Znj. E. D , në mënyrë të vazhdueshme, kryesisht pas Kongresit të 9-të të FSASH (por edhe përpara tij, kur drejtues ishte z.I. R, ka sjellë shqetësime, me statuset e saj në faqen e whatsapp të Këshillit Drejtues të FSASH.

Këshilli Drejtues (KD) është organi drejtues më i rëndësishëm i FSASH, pas Kongresit. Ai përbëhet nga 50 anëtarë që janë njëkohësisht edhe Kryetarë të Seksioneve Sindikale të të NJVA përkatëse.

Në lidhje me shqetësimet që ka përcjellë znj. D. , sqarojmë:

Shqetësimi 1: Për kërkesën “*Informacion me shkrim për transparencën financiare të FSASH*”, jam shpërfillur...nuk më është dhënë...”, arrin deri aty sa thotë se është bullizuar.

Stafi drejtues i kaluar (financierja), para janarit 2025, bëri analizën financiare të hollësishme, në mbledhjen e Këshillit Drejtues me zërat kryesorë: “Të ardhurat; shpenzimet; gjendja.” Në mënyrë unanime, nga të gjithë anëtarët e KD u miratuan shpenzimet për çdo zë. Znj. E. ishte dakort, pasi nuk ngriti probleme. Në muajin janar 2025, znj.D. dërgon një letër në zyrat e FSASH dhe kërkon transparencën e shpenzimeve të 5 viteve më parë, kur gjithë stafi drejtues i FSASH edhe financierja gjithashtu janë të rinj.

Znj.E. për transparencën financiare, nuk paraqet asnjë provë apo fakt për abuzim nga anëtarët e Kryesisë me to. Ajo aludon, hamendëson apo akuza pa baza.

Z.D. është dëgjuar me shumë vëmendje për problemin e transparencës financiare të FSASH dhe është sqaruar për problemin në disa raste dhe me anë të një komunikimi zyrtar në grupin *ehatsapp*.

Shqetësimi nr.2, që ka sjelle te ju, znj.E. , shprehet se: “*kam kërkuar 2 herë me shkrim informacion se cilat janë masat e marra nga KGSE për shkeljet e etikës ndaj figurës time nga znj.Enriketa Zeqo, Kryetare e Seksionit Sindikal Berat*”.

Ja si i përgjigjet znj.D. , znj.E. Z, në faqen e KD: “*E para e di që e mbështet dhe u rimblodhët po ju të 5-të si dikur me forma të shëmtuara. Meme as jam bërë as bëhem. I di të gjitha pozitat që ke pasur, mënyrat se si i ke përdorur dhe përfitur. Nuk jam as hija dhe as zëri i dikujt dhe nuk çuditem as me fjalorin tënd. Por vetëm trajnimin e fundit po të kujtoj se si i ofendove femrat dhe në referimin e saj përfaqësuesja nga Kosova të mori si shembull. Në Vlorë dhe në pjesën e sindikatës më njohin dhe nuk duhet të flasësh, sepse më shumë të njohin se sa i njeh. Por edhe në gjithçka që kam shkruar e kam bazuar në punë time dhe konstatimet personale. Jeta në përballje me elementë të tillë na ka mësuar të dyja anët e medaljes. Grupi besoj e kuptoj tani kur në mbledhje thashë se jam telefonuar dhe kërcënuar. Së fundmi duhet të tregoj se nuk ke punuar për sindikatën sepse pa interes nuk bën asgjë. Ka kaluar koha hiqesh nga grupi si dhe të tjerë sepse keni mbyllur funksionin tuaj. E di që je dhe do të mbetesh aset për disa gjëra por çdo gjë ka një fund.*”

Për këtë sqarojmë se, akuza ndaj znj. E.Z, që bën znj.D. janë të pabazuara në prova. Znj.E. D , nëqoftëse kishte kishte prova për shkelje etike, pse nuk ndërmori nismën ta denonconte znj. E.Z në KGSE. Vetë KGSE nuk ndërmerr nisma të kësaj natyre, pra duhet dikush të denoncojë. Znj.E. Z deri në muajin shtator 2024 ka drejtuar Seksionin Sindikal Berat, më pas ka dalë në pension, dhe u largua nga FSASH. Edhe sikur të kishte shkelur etikën ndaj znj. D. , ç’masë do merrte KSGE për znj. Enriketa Zeqo?

Shqetësimi nr.3 i znj. D. shprehet se: “*Kam ngritur problematika të ndryshme, së bashku me mësueset me anë të një letër-këmbimi me shkresa zyrtare, me MAS, Av.Popullit, M.Financave, Bashkinë Selenicë, ZVAP Selenicë për : transportin e mësuesve, lejen e zakonshme 56 ditë pune, për*

kriteret e procesit të kualifikimit të mësuesve. Për këto probleme unë, E. D , në Grupin e ehatsapp të K.D edhe në mbledhjet e K.D, jam evidentuar si një njeri që ngre probleme për t'u dukur apo për përfitim posti....”

Në lidhje me këtë shqetësim të znj. D. , sqarojmë se, asnjëherë në 2 mbledhjet e K.D të FSASH, ku drejtuesit e saj, janë zgjedhur rishtaz pas nëntorit 2024, znj.E. D , nuk ka ngritur problemet e mësipërme, pasi ato janë objekt i punës tonë, pra, FSASH.

Znj. E. D , është e vërtetë që ka dërguar letra zyrtare nëpër institucione të ndryshme si MAS, MF, Av.Popullit, por ajo ka shpërfillur Drejtuesit Kryesorë të FSASH, duke mos i njoftuar ata (Kryetarin, Sek.Pergjithshem të FSASH), për shkresat zyrtare dhe problemet që përcjell në këto institucione.

Sqarojmë se, znj.D. , jo vetëm që dërgon shkresa zyrtare nëpër institucione qendrore, duke shkelur kompetencat dhe hierarkinë federative, por shqetëson këto institucione duke kërkuar zgjidhjen e problemeve të mësipërme në mënyrë antiligjore si, transporti i mësuesve me linja private, licensimi i mësuesve.

Po ju bëjmë me dije, statusin e datës 25.04.2025 të znj. E. ku akuzon krerët e MAS, kryesisht Sekretarin e Përgjithshëm z.E.T, për shkelje të mënyrës së licensimit të mësuesve (sipas saj) si më poshtë: *“Përshëndetje. Para disa ditësh na hidhet njoftimi për takim të Kryetarit të FSASH dhe Kryetarit të SPASH me përfaqësues të MAS. Megjithëse ankesën e bëra me mbështetjen e mësuesve të cilët ishin dakort duke u nisur nga ky sms i ndalova të bënin pagesën. Ata me respektuan por zyra i mori në telefon dhe u tha, bëni pagesën sepse mbaron afati. Ata e bëni pagesën dhe unë në sytë e tyre dola jokorrekte. Por, personat përgjegjës, apo kompetent në ministri, të cilët nuk e vazhduan ta ndiqnin problematikën edhe pas takimit, do mbajnë përgjegjësi sepse një problematike i shkoj deri në fund. Kam vërtetuar që ndryshe thonë në përballje të ndryshme në mënyrë institucionale. Për këtë po hedh dy dokumenta të ndryshëm njëri që është dërguar në DRAP dhe një në grupin tonë. Vërtetë mund të bëni bashkëpunime, por ato duhet të kenë peshë, sepse janë letra me shumë sesa në realitet.”*

Jo vetëm kaq, por znj.E. akuzon këto institucione, Sekretarin e Përgjithshëm të MAS se do japë llogari për shkeljet e ligjit të licensimit të mësuesve, përgjegjësi do mbajë edhe ZVA Selenicë, për këmbëngulje të licensimit të dy mësuesve në një mënyrë antiligjore.

Ja çfarë shkruan ajo në statusin e datës 12.12.2024, për Kryetarin e FSASH, që gjithmonë për çdo nismë që ai ndërmerr, kjo e fundit i kundërvihet në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu akuzon drejtuesit e ZVA Selenicë për pazare në emërimin e personelit, duke thënë se ajo nuk bën pazare dhe si rrjedhojë ndaj është në fshatin më të largët. Znj. D. thotë si më poshtë: *“.....z.Kryetar Shpëtim Brahaj, para disa kohësh të kam dërguar kërkesë për përfitimet e çdo seksioni sindikal pa përfshirë 20%. Asnjë përgjigje.*

Të kujtoj që jam anëtare e KD është e drejta ime të informohem dhe ti për çdo pozicion që mban e ke detyrim institucional të më kthesh përgjigje (mendoj që respekti i të përgjigjurit duhet të jetë dhe është reciprok)

Pashë ofertat dhe për kolegët e mi nëse ulja do të kishte vlerë në çdo karburant jo vetëm tek B....., po do ia vlente. Në Vlorë ka edhe çmime më të lira. Siguracionin me ulje e paguajmë sepse atë ulje ata e bëjnë duke qenë klientë të rregullt, edhe kjo po të bëhet në çdo pikë të pagesave ose ulja të kishte vlerën 20% do ia vlente. Pra, ofertat janë të përqendruara duke sjellë pasurimin e pronarëve. Kjo ulja 8 lek/litër është qesharake. B.....sh.p.k bën dhe ka bërë ulje çdo sezon kështu që.....Kjo ishte për ofertat.

Mësuesit besoj do të donin ulje tek harxhimet e përditshmërisë së tyre, ushqimet, ilaçet etj.

Duan pagën e tyre sipas shkollës së kryer dhe jo sipas interpretimit të emërtimit të diplomës (e kam kërkuar dhe do e kërkoj edhe në alternativa të tjera të cilat më luten ta çoj si problem) duan shpërblim për vështirësinë e punës, duan përfaqësi dinjitoze nga sindikata sepse FSASH është institucion dhe mision për mbrojtjen e interesave të mësuesve dhe jo përfaqësues i interesave të ngushta të personave që bëjnë pazare për veten e tyre mbi besimin që u kanë dhënë mësuesit. Jam në pritje të konfirmimit të dyshimeve të mia për ndarjen e posteve drejtuese që i shkruajta në sms pas kongresit dhe më pas do i bëj një përmbledhje grupin tim sindikal, shoqërisë time duke iu treguar ja kush e mbroj dhe le të shohin vlerësimet.

Që sot jam në fshatin më të largët dhe në rrugën më të vështirë të Selenicës, është për faktin sepse nuk bëj dot kompromis duke ulur dinjitetin tim duke përdorur forma të shëmtuara për pazare, por çdo gjë e dua nga puna ime dhe djersa ime. E. D ”

Në grupin e Këshillit Drejtues të FSASH, nuk ka një grup që të luftojë “mendime filozofike” të znj.D. , por secili anëtar i KD, e shpreh qartë dhe me forcë mendimin në mbrojtjen e interesave të sindikaliztëve. Anëtarë të KD kanë shprehur kundërshtimet e tyre në lidhje me mendimet regressive të znj.E. .

Sa i takon shqetësimeve të znj.D. se këto probleme i ka ngritur edhe në grupin e *ehatsapp* të K.Drejtues sqarojmë se:

Po, znj.D. në *ehatsapp* e faqes zyrtare të K.Drejtues, ka qenë shumë aktive, por jo për problemet e mësipërme, por, duke atakuar, të zgjedhurit në mënyrë demokratike të FSASH, duke filluar nga Kryetari z.Sh.B, Sek.Pergjithshëm z.S.K, Sek.Organizativ z. B.Sh, Kryetari KGSE z. R.Gj dhe kryetarë të tjerë të Sek.Sindikale, me lloj-lloj akuzash, që nga mungesa e aftësisë të të zgjedhurve (nuk duhet të ishte ti R. Gj si kryetar i KGSE, nuk plotëson kushtet) (apo të tjerë duhet të ishin zgjedhur si drejtues të FSASH, të ishim ne femrat...)

Pra, “areali” i nëpërkëmbjes nga znj.D. në *ehatsapp* janë: institucione arsimore lokale, ZVA, DRAP, institucione qendrore si MAS, persona që fillojnë nga, Kryetarë Sek.Sindikale, Kryetarin e FSASH, Sek.Organizativ, Sek.Përgjithshëm FSASH, kryetari KGSE, e Sek.Pergj MAS z.E.T (Drejtoreshën e ZVAP Selenicë e mori në *ehatsapp* në mbledhjen e KGSE duke i bërë presion, duke shkelur etikën dhe rregullat elementare të veprimtarisë dhe funksionimit të institucioneve).

Në shqetësimin 4, znj.D. thotë se: “Jam ofenduar nga anëtarët e grupit ehatsappsi spiune, them gënjeshtër, brockulla, merrem me thashetheme” etj, përmend emrat Sh. B -Kryetar i FSASH, S. K - Sek.Përgjithshëm, B.Sh, Sek.Organizativ etj. Nuk ka asnjë provë dhe fakt që drejtuesit e FSASH e kanë quajtur znj.D. si spiune, që thotë gënjeshtër apo bën thashetheme.

Për shqetësimin 5, të znj.D. , ku ajo shprehet se më datë 27.04.2025, ka patur një komunikim me sms, me grupin e punës, i ngritur për të ndihmuar seksionet sindikale, ku më njoftuan se do të vinin në Vlorë, për takim me mua, por unë i njoftova se duhet të ishte Kryetari i ri, Sh.B, në takimin e parë me Kryetarët e shkollave për t’i dëgjuar direkt, por erdhi grupi i punës, z.B.S, z.S. K dhe z.A. K, anëtar Kryesie, në orën 2 e 30, pas pune.

Për këtë shqetësim të znj.D. , theksojmë se, axhenda për “ndihmë dhe kontroll” ndaj Sek.Sindikale të çdo ZVA të NJVA ishte përgatitur muaj më parë nga grupi i punës dhe kishte marrë miratimin e K.Drejtues, Kryesisë dhe Kryetarit të Federatës. Ajo nuk mund të ndryshohet, sipas kërkesave të Kryetarëve të Sek.Sindikale.

Sqarojmë se, znj.D. , mund ta thërriste në takim me Seksionin Sindikal të saj, Kryetarin e Federatës z.Sh. B, në çdo kohë që të dëshironte, ai, si në çdo Seksion tjetër që ka shkuar, do shkonte dhe në Selenicë.

Mendojmë që qëllimi i znj.D. , për këtë problem ishte që të tensiononte takimin me Grupin e Punës, ashtu si edhe ndodhi me pjesmarrësit e Seksionit Sindikal Selenicë. Që në fillim, si hapi mbledhjen, pa bërë prezantimin e pjesmarrësve në takim, u shpreh se: “Ne, sot në këtë takim, këtu në Vlorë, prisnim Kryetarin z. Shpëtim Brahaj. Ai duhet të vinte këtu të jepte llogari, për transportin e mësuesve, licencat që nuk zbatohet ligji, për zyrat, pse nuk i ka blerë, ashtu siç premtoi? Për 1 Majin, që pse spo bëhen organizime sindikale, protesta etj.”

Theksojmë se “hovin” e znj.D. e ndërpre në vetën anëtarët e Seksionit Sindikal Selenicë. Grupi i punës i kërkoi të mbahej procesverbal për mbledhjen e tij me Seksionin Sindikal Selenicë, por znj.D. prerë tha: “ mbajeni vetë, dhe ju drejtua të “vetëve” asnjë prej jush nuk do ta mbajë atë.” Pra në këtë mbledhje, ne, grupi i punës jemi ndjerë të fyer, nëpërkëmbur, të pavlerësuar dhe bullizuar, nga znj.D.

Në këtë mbledhje znj.D. kishte marrë dhe 2 mësueset, të cilat, ishin regjistruar për të dhënë provimin e licencës për profesionin e mësuesit, por, znj.D. ju thoshte: “*Ju nuk ju takon të jepni këtë provim*”. Për këtë problem, pra, të mos licensimit të këtyre dy mësuesve ajo bezdiste institucionet arsimore, ZVA, DRAP, MAS me shkresa zyrtare, që ajo përmend në letrën që ju dërgon dhe ju. Kërkesë antiligjore e quan ZVA Selenicë. Kapërcim kompetencash e vlerëson MAS.

ZVA Selenicë, znj.D. i bën presion, duke i thënë se është konsultuar me juristin e FSASH dhe ai i njeh mirë ligjet, këta dy mësues nuk duhet të licensohen. Kur juristja e ZVA Selenicë i kërkoi numrin e telefonit të juristit të Federatës, për të sqaruar situatën znj. E. “nuk ta jap” i thoshte. Të njëjtën kërkesë, për mos licensimin e 2 mësuesve, znj.D. e dërgon në DRAP dhe MAS, duke i akuzuar ata

se do të mbajnë përgjegjësi për “moszbatim” të ligjit, sidomos Sekretarin e përgjithshëm të MAS z.E.T.

Por, mbledhja e grupit të punës dhe pjesarëve të sek.Sindikale Selenicë mori një kthesë të fortë, pasi të 2 mësuesit që znj.D. i detyronte të mos licensoheshin, pranuan se: jemi regjistruar dhe kemi bërë pagesën në bankë për tu licensuar, në përmbushje të ligjit, të profesioneve të rregulluara.

Mbledhja në Vlorë vazhdoi me pikat e tjera të axhendës dhe konkretisht me plotësimin e pyetësorit të përgatitur nga grupin e punës dhe miratuar në Këshillit Drejtues dhe Kryesi. Znj.D. ju përgjigjet pyetjeve të pyetësorit në mënyrë sipërfaqësore, pa argumenta, duke nënvlerësuar grupin e punës dhe pjesmarrësit në mbledhje. Sqarojmë se grupi i punës, pyetësorin si pjesë të axhendës ekishte përcjellë paraprakisht në grupin e Këshillit Drejtues, faqen e *ehatsapp* kohë para se të shkonte nëpër seksionet sindikale.

Në vazhdim të shqetësimit në pikën 5, të znj.D. ajo shprehet se : “Grupi i punës pa më njoftuar mua, shkojnë në Selenicë dhe zhvillojnë takime në shkollën e mesme “Hajredin Beqari” ku takojnë Drejtoreshën e Shkollës dhe kryetaren e këshillit Sindikal, duke më anashkaluar mua.” Për këtë sqarojmë se, Grupi i punës në axhendën e vet, gjatë kontrollit dhe ndihmës nëpër Sek.Sindikale kishte edhe takime me përfaqësues të punëdhënësve si Drejtorë ZVA, Drejtorë Shkollash, Kryetarë të Këshillave Sindikalë nëpër shkolla, mësues të pa anëtarësuar në Sindikatë etj. Këtë axhendë kishin dhe në NJVA Selenicë, edhe patëm shumë sukses nga takimet me aktorë të ndryshëm dhe krijuam një ide për punën e Sek.Sindikale aty.

Kontrolli në Seksionin Sindikal Selenicë u zhvillua në datën 28 prill 2025, ditë e hënë, ku znj. E. D ishte në mësim me nxënësit. ne nuk mund të marrim zonzjën, pasi do të cenonim orarin e saj mësimor, të shkollës dhe të linim nxënësit pa mësim. Kështu që pretendimet e znj.D. se e anashkaluam apo nuk respekтуam personin e saj, nuk qendrojnë, bien poshtë.

Për shqetësimin e 6, znj. D. shprehet se: “*Kërkesa ime dhe e kryetarëve të shkollave, për protestën e 1 Majit e hodha në Grupin e KD nga ku solli reagime, ofentime, diskriminim, për të cilat marr vërejtje vetëm unë, ndërsa të tjerët jopër sjellje të paprështatshme dhe shkelje të etikës, në komunikimin publik*” duke vazhduar “*Në takimin e Vlorës, Kryetarët e K.Sindikale të Selenicës, ju kërkon përfaqësuesve të grupit të punës të organizohej diçka për 1 Majin. këtë gjë e kërkova dhe vetë. Jo vetëm që spati prononcim, por më sulmuan njësi pas tjetrit, të njëjtët persona, anëtarë të KD që bullizojnë përherë*”

Komunikimi midis znj.E. dhe përgjigja e z.S.K, Sekretar i Përgjithshëm, në *ehatsapp* është zhvilluar si më poshtë:

Znj. D. : “*Sot është 1 Maji dita e punëtorit, ku është aksioni sindikal pra protesta??? Mos realizimi i saj nuk u bën ndryshe nga të tjerët. Prita së bashku me kryetarët e shkollave të realizohej dhe kjo u evidentua edhe në mbledhjen e grupit të punës. Sa për informacion z.S. nuk kam thënë kurrë që të blejmë zyrat por Z.kryetar ka thënë duhet të kemi zyra dinjitoze për të cilat do marrim ambjente të tjera me qira, këtë ia kam thënë në mbledhjen e KD dhe tha po e kam thënë por gjerat nuk bëhen me*

pult do realizohen në vazhdim. Sa për gënjeshttrat shiko mos i ke bërë vetë sepse unë i kam me fakte dhe me përballje. Dhe do ti drg. në grup jo si ti. Sepse me vajtjen tuaj në atë formë keni lënë përshtypje jo të mira për performancën e FSASH në qendër. Drg sms e mesueses dhe njëherazi kryetare e shkollës me screenshot për atë që ke shkruajtur më lart. Po përdor një thënie mjaft të bukur: " Faji më i madh në botë është t'i mbash anën të padrejtit dhe të jesh armik i të drejtit"

Z. Karaj thotë: *"Përsa i përket 1 Majit, kam qenë ndër të parët që kam ngritur zërin personal sot, por situata momentale na detyron në mungesën e një aksioni sindikal.*

Për shqetësimin e përcjellë tek Ju të znj. D. , sqarojmë se:

Viti 2025, deri më 11 Maj 2025, ishte vit elektoral, për zgjedhjet e Pushtetit Qendror. Si i tillë, Kodi Elektoral, nuk lejon takime, protesta, organizime sindikale. Znj.D. gënjen, kur thotë se FSASH dhe strukturat e saj nuk u prononcuan me një Deklaratë në Grupin e KD, për 1 Maj 2025, po paraqesim prononcimin nga Sek.Përgjij. i FSASH, Z. S. K: "1Maj-Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve" Kaq sa lejonte ligji elektoral.

Statuti i FSASH lejon Seksionet Sindikale dhe Kryetarët e tyre, të çdo NJVA të bëjnë organizime, takime deri në protesta, për zgjidhjen e problemeve që kanë, deri në arritjen e objektivave dhe synimeve të tyre. Pse znj. D. nuk e përdori Nenin 3.3 që thotë se: " FSASH- nuk dikton në veprimtarinë e brendshme sindikale të seksioneve, Këshillave apo organizatave sindikale. Ajo respekton pavarësinë dhe vullnetin e tyre, me kusht që ato të jenë në përputhje me parimet dhe normat e këtij statuti".

Më tej, znj. D. aludon se: "Nga mesazhi që përcolli në grupin e KD (ëhatsapp) mori si gjithmonë ofendime, kërcënime, bullizim nga i njëjti grup që e bullizon atë" !!

Sqarojmë se, në K. Drejtues të FSASH, të gjithë janë Kryetarë të Sek.Sindikale të NJVA përkatëse. Nuk ka në këtë strukturë "grupe bullizuesish" të Kryetarëve dhe kolegëve të tyre, as për znj.D. . ndërkohë që sms e znj. D. më 1 Maj me shumë ishte kërkesë për debat dhe nxitje të përçarjes mes anëtarëve të KD.

Arritjet e FSASH, nga Janari 2025-Korrik 2025, për realizimin e objektivave janë domethënëse, kjo është realizuar nën drejtimin e K.D, si struktura më e lartë drejtuese e FSASH, pas Kongresit.

Z.D. , në letrën që përcjell tek Ju, vazhdon se: *"Fill pas sulmeve dhe bullizimit me fjalë fyese, Sekretari i Përgjithshëm hedh në grupin e ëhatssapit, njoftimin se: Kryesia e FSASH më jep masë disiplinore, (duke shkelur statutin e Federatës), me motivacionin, "për prishje të qetësisë së antarëve të K.D në ditë pushimi. Që nga 1 Maji, ëhatsappi K. Drejtues është hapur sot më datë 29.05.2025, por duke hequr të drejtën e antarëve të K.D të shkruajnë e të komentojnë".*

Komunikimi në ëhatsapp për tërheqje vëmendje, nga z.S. K: *"Tërheqje Vëmendje.Të nderuar kolegë të Këshillit Drejtues,*

Kjo faqe i shërben seksioneve sindikale të Federatës për të transmetuar problematikat, shqetësimet dhe veprimtarinë e sindikatës.Megjithatë, herë pas here është vënë re se disa kryetarë seksionesh shfaqen në këtë faqe me statuse joetike, që kundërshtojnë kolegë të tjerë, anëtarë të Kryesisë,

tejkalojnë kompetencat e tyre dhe krijojnë përplasje të panevojshme rreth çështjeve të zakonshme sindikale – siç ndodhi sot me znj. E. . Në një mbledhje të kërkuar nga disa anëtarë të Këshillit Drejtues dhe anëtarë të Kryesisë. Kryesia vendosi unanimitisht në një mbledhje online, t'i japë vërejtje znj. E. , për sjellje të papërshtatshme dhe shkelje të etikës në komunikim publik. Jemi të bindur se shumë prej këtyre qëndrimeve kundërshtuese "gëlltiten" pa qëllim nga ata që nuk janë të njohur me punën e Kryesisë dhe të Komitetit të Këshillit të Federatës, e cila përcaktohet qartë nga: Neni 4, pika 4.6/c dhe pika 4.6/9; Neni 6, pika 6.14 e Statutit të Federatës.

Statuset joetike dhe qëndrimet kundërshtuese janë kthyer në shqetësim për anëtarët e KD-së, të cilët nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë apo të kalojnë kompetencat që u takojnë organeve të tjera të FSASH, përfshirë edhe Komisionin e Etikës."

Z.D. vazhdon se: "*Grupi i ëhatsappështë për të paraqitur e diskutuar problematika dhe jo të mbyllim gojën sepse ju intereson. Kjo faqe i shërben S.Sindikale për të transmetuar probleme, shqetësime dhe veprimtarinë e Sindikatës ku veprimtaria duhet të jetë e bazuar në statut dhe jo në veprimtari private me imponim."*

Për këto "shqetësime" të znj. D. , sqarojmë se, ajo, përdor mirë "sulmin për t'u mbrojtur". Ajo, në mënyrë të vazhdueshme ka përdorur faqen e *ëhatsapp* të K.Drejtues, duke hedhur statuse dezinformuese, destabilizuese, kërcënuese, keqdashëse, duke akuzuar padrejtësisht dhe pa asnjë shkak të arsyeshëm, drejtuesit kryesorë të FSASH dhe kryetarë të tjerë të strukturave drejtuese të saj. Një pjesë të këtyre statuseve të znj.D. , po i dërgojmë dhe tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të bindeni shkresërisht që znj. E. , jo vetëm nuk është diskriminuar, apo bullizuar nga askush, prej antarëve të K. Drejtues, por, e kundërta ka ndodhur, ajo ka bullizuar disa prej tyre, duke shkelur çdo lloj norme njerëzore dhe etike. Edhe pse në mënyrë të vazhdueshme, znj. D. i është tërhequr vëmendja dhe këshilluar nga titullarë strukturash të Federatës, Sek.Përgjij., Sek.Organizativ, Kryetari KGSE, apo antarë të tjerë të K.Drejtues, të ndërpriste përcjelljen e kësaj gjuhe, në kundërshtim flagrant me normat dhe parimet statutores, ajo vazhdoi deri në fund.

Nqs znj. E. D do vazhdonte të qëndronte në pozicionin e anëtares së K. Drejtues dhe Kryetare e S.Sindikale Selenicë me statuset që ajo përdorte kundër interesave të FSASH dhe synimeve dhe objektivave që Federata ka, në mbrojtje të interesave të antarëve sindikalistë, më e pakta do përçante K. D, Sek.Sindikale dhe antarësinë. Shpesh herë ajo bënte "presion" me statuset e veta në K. D me sindikata të tjera duke propaganduar" punën dhe rezultatet e tyre, të gjitha këto në dëm të interesave të FSASH. Në këto kushte, strukturat drejtuese të FSASH, kryesia, KGSE, dhe drejtuesit kryesorë e theksojmë: duke parë intensitetin e punës destabilizuese, që po bënte znj.D. , dhe mos tërheqja e saj nga kritikrat dhe vërejtjet që i bëheshin në vazhdimësi, u ndërmorrën hapat e mëposhtëm:

1. KGSE, më datë 30.04.2025, ka marrë vendim, për mbledhje *online* së bashku me kryesinë e FSASH, që do të zhvillohej më datë 02.05.2025 me rend dite: "Analiza e veprimtarisë së 2-3 Kryetarëve të S.Sindikale, një prej tyre dhe znj. E. për veprimtari anti-statutores dhe rezultate të dobëta në seksione e tyre".

2. Në datë 01.05.2025 u mblodh Kryesia e FSASH, jashtë radhe *online*, për problemet kryesisht qëndrimi që do mbahej nga gjendja e krijuar në K. D, kryesisht në faqen e *ëhatsappit*, dhe problemet

që ka shkaktuar z.D. . U vendos që, faqja e *ehatsapp*, të K. D, do mbyllet për postime, pas orës 16:00 dhe gjatë ditëve të pushimit. Për raste urgjente, të kontaktoni me Sek.Përgjithshëm, z.S. K, në mënyrë private. Po në këtë mbledhje Kryesia, datë 01.05.2025, me kërkesë të disa Kryetarëve të Sek. Sindikale dhe antarëve të Kryesisë, Kryesia e Federatës, vendosi unanimisht: *"T'i jepet vërejtje znj. E. D. për sjellje të pa përshtatshme dhe shkelje të etikës me mënyrën e komunikimit të saj në faqen zyrtare të ehatsappit të K. D."*

3. Në datë 02.05.2025, Kryesia vendosi: *"Mbylljen e faqes së ehatsapp të K.D, për postime nga antarët dhe do hapej me kërkesë të antarëve të kryesisë dhe antarëve të K. D"*. Kryesia vendosi edhe: *"Të dërgohet çështja e znj. E. D në KGSE"*

4. Në datë 19.05.2025, u mbledh KGSE dhe vendosi: Në mbledhjen e rradhës, që do mbahet me datë 27.05.2025, të thirren 3 Kryetarët e Sek.Sindikale, midis tyre edhe znj. E. D , të dëgjoen dhe të mbrohen me argumentat e tyre, për shqetësimet që kanë shkaktuar, para antarëve të KGSE. KGSE vendosi që të lajmërohen Kryetarët e S.Sindikale, për çështjet që do diskutohen për ta, midis tyre edhe z.D. . KGSE-vendosi, që mbledhjen e rradhës ta mbajë në datën 27.05.2025, ditë e Premte, ora 11:00, tek zyrat e FSASH. Në këtë mbledhje të KGSE, nga 3 Kryetarë Seksionesh, erdhën 2, midis tyre, z.E. D , e cila, u njoh me masën e marrë nga KGSE dhe ju dha mundësia ligjore të paraqiste argumentat e saj duke mbrojtur veten, dhe hedhur poshtë masën disiplinore. Kjo tregon se, rruga që është ndjekur nga organet strukturore të FSASH, janë transparente, demokratike dhe në mbështetje të Statutit të FSASH.

5.Në këtë mbledhje të KGSE, datë 27.05.2025, morën pjesë: Sekretari Përgjithshëm si relator, Sekretari Organizativ si pjesë e Grupit të ndihmës dhe kontrollit; R. Gj, Kryetar KGSE; I. Th, Zv.Kryetar KGSE, Eduart Meta antar KGSE, B. Z anëtare KGSE, që mbajti Protokollin. Theksojmë se, në mbledhjen e KGSE, z. D. u dëgjua plotësisht. Në një moment ajo kërkoi ballafaqim me Drejtoreshën e ZVA Selenicë. Drejtoresha e ZVA Selenicë i tha qartë se: *"Ju, znj. D. vini në ZVA dhe kërkoni zgjidhjen e problemeve në mënyrë antiligjore, kur ne të kërkojmë të na japësh numrin e celularit të juristit të FSASH, që të konsultohet juristja e ZVA me të, ju nuk e jepni."* Këtë, Drejtorja e ZVA Selenicë e ka theksuar dhe në shkresën që dërgoi në FSASH, për problemin e znj. D. . Në shkresë përcjellëse për FSASH thuhet, që marrëdhëniet ZVA Selenicë me Kryetarin e Sek. Sindikal Selenicë, nuk janë në lartësinë e duhur, sepse znj. D. , si në ZVA dhe në institucione të tjera eprore, në kundërshtim me kompetencat që ka, ZVA dhe vetë Kryetarja e Sek .Sindikal, kryesisht për licencat e mësuesëve.

KGSE- në këtë mbledhjen e datës 27.05.2025 vendosi që: *"Problemi i znj. D. (edhe pasi u dëgjua), të qëndrojë propozimi i mbledhjes së dt. 19.05.2025 dhe të dërgohet në K. Drejtues. Ne antarët e KGSE në mënyrë unanime i propozojmë K. D, që ajo të përjashtohet nga rradhët e tij dhe njëkohësisht si Kryetare e Sek. Sindikal Selenicë"*.

6. Në datën 04. 07.2025 u zhvillua mbledhja e Këshillit Drejtues të FSASH, midis të tjerave u diskutua edhe problemi i znj.E. D . Pasi diskutoi Sek. Përgjithshëm z. S. K, për shkeljet statutoore që ka bërë znj. D. , ju dha fjala znj. D. . Pavarësisht se në ankesën që ka përcjellë tek Ju, dhe pretendon

se nuk e lanë të diskutonte për të sjellë argumentat e saj, për t'u mbrojtur në këtë mbledhje, ju bëjmë me dije se ajo foli gjatë, duke treguar edhe historikun e jetës së saj, origjinën. Ajo nuk paraqiti asnjë fakt apo provë që të hidhte poshtë masën disiplinore që i ishte dhënë nga KGSE.

Për t'u theksuar është se, ajo kur diskutoi, në mbledhjen e K.D, nuk qëndroi në karrigen dhe rreshtin ku ishte ulur, por doli në krah të podiumit dhe ballë për ballë me antarët e K.Drejtues. "Dua t'ju kem përballë tha, se kështu flas më mirë". Znj. D. foli aq sa s'kishte çfarë të thoshte më, pasi mbaroi diskutimin, shkoi dhe u ul në karrigen e saj.

Sek. Përgjithshëm, hodhi me votim propozimin e KGSE, për përjashtimin e znj. D. nga rradhët e K.Drejtues dhe si Kryetare e Sek.Sindikale Selenicë. Si përfundim, me shumicë votash të antarëve të K.D, ajo, u përjashtua nga rradhët e KD dhe njëkohësisht si Kryetare Seksioni të NJVA, Selenicë.

Në datë 11.07.2025, meqënëse Z. D. u përjashtua nga K.D me dt 4.07.2025, ajo u hoq dhe nga grupi i *ehatsapp* të këtij Këshilli.

Në datë 14.07.2025, znj. D. kërkon dokumentacionin shkresor, në lidhje me vendimin e K.Drejtues, për përjashtimin e saj nga rradhët e tij. Brenda afatit ligjor, ju vu në dispozicion gjithë dokumentacioni i kërkuar prej saj. Pavarësisht se në ankesën që drejton tek Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, znj. D. thotë se, nuk m'i kanë dhënë dokumentat që kam kërkuar.

Nenet e Statutit të FSASH, që ka shkelur z. D. gjatë veprimeve dhe mosveprimeve të saj, janë:

Neni 6.14 thotë se "K.D mund të marrë masa disiplinore, deri në përjashtim nga rradhët e veta edhe për antarët e tij, kur ata i kundërvihen statutit, normave dhe parimeve mbi të cilat është ndërtuar dhe funksionon FSASH, kur ata përpiqen të denigrojnë arritjet dhe reputacion e FSASH, shkelin Kodin e Etikës. Në këto raste merret për bazë edhe gjykimi i KGSE.

Neni 4, pika 4.8 b që thotë se: "I anëtarësuar në FSASH është i detyruar të zbatojë vendimet e Organizatës Sindikale ku bën pjesë, të Këshillit Sindikal dhe Seksionit të Njësisë Vendore, si dhe organeve më të larta të FSASH".

3. Në datën 25.08.2025, pala ankuese depozitoi (me *e-mail*) prapësimet e saj, të cilat do të trajtohen në vijim të vendimit.

4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: "*Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.*" si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore në datë 15.10.2025. Seanca dëgjimore iu komunikua palëve me shkresën nr. 856/4 prot., datë 17.09.2025.

Seanca dëgjimore e datës 15.10.2025, nuk u zhvillua, pasi me shkresën nr.169 prot. datë 10.10.2025, FSASH kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore për shkak të pamundësisë për të marrë pjesë, pasi ndodhej në një aktivitet ndërkombëtar. Për t'i dhënë mundësinë për të qenë prezent, Komisioneri vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore për një datë tjetër.

Me shkresën nr.856/5 prot, datë 21.10.2025, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 13.11.2025. Me shkresën nr.178 prot., datë 7.11.2025, FSASH, kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore, pasi në të njëjtën datë FSASH ishte thirrur në komisionet parlamentare në kuadër të shqyrtimit të buxhetit për vitin 2026, për sindikatat. Komisioneri vlerësoi të shqyjë seancën dëgjimore, për ti dhënë mundësi FSASH për të qenë prezent në seancë dëgjimore.

Me shkresën nr. 856/7 prot datë 20.11.2025, Komisioneri njoftoi palët për një tjetër seancë dëgjimore në datë 10.12.2025. Nëpërmjet shkresës nr.183 prot., datë 012.2025, FSASH kërkoi sërish shtyrjen e seancës dëgjimore, për shkak të pjesmarrjes në një seminar jashtë vendit. Komisioneri vlerësoi të shqyjë seancën dëgjimore, për ti dhënë mundësi FSASH për të qenë prezent në seancë dëgjimore.

Me shkresën nr. 856/9 prot., datë 10.12.2025, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 22.12.2025. Në datën 18.12.2025, pranë Komisionerit është administruar kërkesa e Av.A. S për shtyrjen e seancës dëgjimore. Referuar dokumentacionit shoqërues, rezultoi se bazuar në autorizimin nr.184 prot., datë 15.12.2025, Av.A.S, është autorizuar për të përfaqësuar FSASH, ndër të tjera pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, Av.A.S, në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar të FSASH kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore për shkak se ndodhej jashtë shtetit për arsye familjare. Komisioneri vlerësoi se, kërkesa për shtyrjen e seancës dëgjimore e paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, nuk ishte e justifikuar.

Komisioneri vlerësoi se mungesa e FSASH në seancën dëgjimore të datës 2.12.2025, nuk ishte e justifikuar dhe se FSASH i ish in ofruar të gjitha mundësitë për të marrë pjesë. Në këto kushte, Komisioneri çmoi se senanca dëgjimore duhet të vijonte në mungesë të FSASH.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesmarrjen e palës ankuese, e cila në parashtrimet e saj i qëndroi parashtrimeve me shkrim të cilat kishte depozituar pranë Komisionerit.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja E. D , është anëtare dhe njëkohësisht Kryetare e Seksionit Sindikal Selenicë, të FSASH. Në cilësinë si Kryetare e Seksionit Sindikal Selenicë, ankuesja është anëtare e Këshillit Drejtues të FSASH. Sipas nenit 6, të Statutit të FSASH, Këshilli Drejtues i FSASH është organi më i lartë që drejton gjithë veprimtarinë midis dy kongreseve të FSASH, ndërsa Kongresi i FSASH, në referim të nenit 5, të Statutit të FSASH është organi më i lartë i saj.

Nga aktet e administruara rezulton se Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH), është regjistruar si person juridik në regjistrin e organizatave jo fitimprurëse me vendimin nr.85, datë 18.01.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Objekti i veprimtarisë së FSASH është, të përfaqësojë e mbrojë interesat ekonomike, sociale e profesionale të punonjësve të arsimit dhe të shkencës në përgjithësi dhe të atyre që janë të anëtarësuar në FSASH posaçërisht.

Rezulton se, ankuesja në mënyrë vijuese ka mbajtur qëndrime kritike në lidhje me mënyrën se si është zhvilluar Kongresi i 9 i FSASH. Ankuesja nëpërmjet komunikimeve të ndryshme në grupin e Këshillit Drejtues të FSASH në *ehatsapp*, paraqet qëndrimin e saj kritik strukturave ose të zgjedhurve të ndryshëm të FSASH dhe për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të organizatës.

Në një status të datës 11.10.2024, ankuesja shkruan: *"Së pari ndjesë për orën që po shkruaj sepse ditë e ngarkuar. Mirëmbërëma ! Njihem si njeri që ti them gjërat në sy dhe nuk kam frikë nga asgjë dhe nga askush në pamundësi po shkruaj. Cilido mund të kërkoj përballje ashtu siç kam kërkuar dhe kërkoj edhe une në vazhdim. Dua të bëj një përmbledhje të këtij kongresi i cili është pothuajse i njëjti me 8-tën, por ky 9-ta pak më mirë i përpunuar kurse për mënyrën e pabesisë është i njëjti. E çuditshme për mua: tërheqja e kandidatit minutën e fundit sepse mbajti edhe referantin kaq mirë të formuluar me shumë arritje me duket ktheu qokën e kongresit të 8-të, mos reagimi i dy kolegeve kur iu permend emri për seksionet, heshija e delegateve kur na tregojnë gjëra çfarë do bejmë e përfitojmë kur ne duam gjëra konkrete të prekshme. Vure re se gjojnë ofertat si mbajtja e vendit kryetar/e sipas antarësisë por harroni se u votojnë mësuesit o kryetar dhe kryetare. Dikush do post, dikush karrierë, dikush do të mbajë vendi që ka. Sot duhet të ishte njëra nga ne e përzgjedhur sepse boll e drejtuan meshkujt. edhe ne dimë të drejtojmë sepse arritjet duhet të vlerësohen për një kohë të shkurtër dhe jo për një kohë të gjatë. Vure re që delegatet femra nuk e përkrahën një femer nuk e vlerësuan sepse lufta brenda llojit është më e ashpër, merrni pjesë edhe në trajnime si ta përkrahim dhe vlerësojmë femrën... U bënë akuza kundrejt kryetareve, sindikatës, shpenzimeve kur sot në sallë ishin vetë përfituesit dhe di që është kërkuar transparencë e përfitimeve të secilit antarë të kryesisë, përse ky dokument nuk ndodhet në dorën e çdo antari të KD për transparencë gjithmonë unë e dua këtë transparencë. E dini pse nuk u dha sepse adresuesit për kryetar janë pjesë e saj por edhe të tjerë që kanë pasur forma dhe mënyrat që mund ti denonconin edhe më parë por nuk e kanë bërë sepse janë pjesë e përfitimeve, vazhdojnë të kërkojnë përfitime dhe pse pikerisht sot ?? Por koha është treguesi më i mirë kush mban dhe do e mbaj fytyrën dhe kush masken ??? Nuk e di se sa të qetë jeni ju që shitet 'shpirtin' ama them drejtësia hyjnore ua përktheftë."*

Në një tjetër mesazh në grupin *ehatsapp* të Këshillit Drejtues të FSASH, i cili ka palët pranohet se i përket datës 12.12.2024, ankuesja ka shkruajtur qëndrimet e saj në lidhje me një nismë të ndërmarrë nga kryetari i FSASH, që sipas ankueses nuk adreson problematikat reale që kanë mësuesit. Në këtë mesazh, ankuesja parashtroi: *"Jam dakort për pjesëmarrjen në mbledhje.....Z. kryetar Shpëtim Brahaj, para disa kohësh të kam dërguar kërkesë për përfitimet e çdo seksioni sindikal pa përfshirë 20%. Asnjë përgjigje. Të kujtoj që jam antare e KD është e drejta ime të informohem dhe ti për pozicionin që mban ke detyrim institucional të më kthesh përgjigje (mendoj që respekti i të përgjigjurit duhet të jetë dhe është reciprok). Pashë ofertat dhe për kolegët e mi nëse ulja do kishte*

vlerë në çdo karburant jo vetem tek B..., po, do ia vlente. Në Vlorë ka edhe me çmime më të lira. Siguracionin me ulje e paguajmë sepse atë ulje ata e bëjnë duke qenë klient të rregullt, edhe kjo po të bëhet në çdo pikë të pagesave ose ulja të kishte vlerën 20% do ia vlente. Por, ofertat janë të përqëndruara duke sjellë pasurimin e pronarëve. Kjo ulja 8 lek /litër është qesharake. B..... shkp bën dhe ka bërë ulje në çdo sezon kështu që Kjo ishte për ofertat. Mësuesit besoj do të donin ulje tek harxhimet e përditshmërisë së tyre ushqimet, ilaçet, etj. Duan pagen e tyre sipas shkollës së kryer dhe jo sipas interpretimit të emërtimit të diplomës (e kam kërkuar dhe do e kërkoj edhe në alternativa të tjera të cilat më luten ta çoj si problem) duan shpërblim për vështirësinë e punës, duan përfaqësi dinjitoze nga sindikata sepse FSASH është institucion dhe mision për mbrojtjen e interesave të mësuesve dhe jo përfaqësues i interesave të ngushta të personave që bëjnë pazare për veten e tyre mbi besimin që u kanë dhënë mësuesit. Jam në pritje të konfirmimit të dyshimeve të mia për ndarjen e posteve drejtuese që i shkruajta në sms pas kongresit dhe me pas do i bëj një përmbledhje grupit tim sindikal, shoqërisë time duke iu treguar ja kush u mbron dhe le të shohim vlerësimet. Që sot jam në fshatin më të largët dhe në rrugën më të vështirë të Selenicës, është për faktin sepse nuk bëj dot kompromise duke ulur dinjitetin tim duke përdorur forma të shëmtuara për pazare, për çdo gjë e dua nga puna ime dhe djersa ime."

Në vijim të diskutimeve, ankuesja shprehet: "M.. Vetëm për votë të lirë nuk mund të flasësh por të diktuar po jam dakort dhe sa për presionet lexoj mirë rreshtat e shkruara ose informohu. Pronare as kam qenë dhe as do jem por mbështetja e të vërtetës po, gjithmonë." "R.: Duke i patur të pjekura mendimet i shkruajta dhe për sa seriozitetin e përzgjedhjeve dhe vazhdimësinë duhet ta fillosh nga vetja jote mendoj ...sepse siç thua jemi misionar dhe me edukim qytetar. Çfarë të bëj unë që jam e drejtpërdrejtë, nuk ndryshoj dot." "Gj., nëse nuk e sheh veten në nivelin e atyre që përfaqëson. Atëherë, si je zgjedhur dhe vazhdon ti përfaqësosh? Parcelizimi i mendimeve dhe veprimeve vijnë si rezultat i mos realizimit të atyre që premtojmë ose i zvarrisim. Besoj kemi pritur boll, apo jo ??"

Rezulton se në datën 21.12.2024, pas hedhjes në grupin e *ehatsapp* të Këshillit Drejtues një njoftim që lidhej me masat dhe detyrat në realizim të Kongresit të FSASH, nga ana e Sekretarit Organizativ të FSASH, ankuesja ka parashtruar qëndrimin dhe komentet e saj në lidhje me këtë njoftim: "Kur shkruhen të vërtetat disa i emërtojnë budallallëqe, kurse kur shkruhen budallallëqe do i duartrokisni si gjithmonë. Po flasim për dypunësimet ti je i pari, që nëse do paguhesh siç është paguar paraardhesi juaj do jesh në shkelje sepse je katërfish i paguar. E dyta që të bësh antare duhet të kesh apo të fillojmë antarësimin nga e para ose riflasim ata që kanë dalë në pension se mos na duhen. Po kryetarët që japin kurse nëpër qendra të ndryshme, trajnime etj. Rishikoje planin të lutem, sepse nuk është i saktë."

Gjatë një tjetër diskutimi, ankuesja shkruan në grupin e *ehatsapp* të Këshillit Drejtues të FSASH: "Edhe mua nuk me kuadron zgjedhja juaj si sekretar i përgjithshëm, sepse shumë pak të kam dëgjuar të flasësh apo të shkruash. Kurse unë emrin e sindikatës FSASH-it dhe mësuesve antarë të saj u kam zgjidhur problemet duke u përballur e vetme."

Gjatë një tjetër diskutimi, ankuesja shkruan në grupin e *ehatsapp* të Këshillit Drejtues të FSASH: "*Z.R., nuk habitem me përgjigjen tënde sepse në këtë funksion të Garancive Statuore arsimimi yt nuk ka pikën e lidhjes me fushën juridike që duhet ta përfaqson dikush i diplomuar në këtë profil*".

Në muajin janar 2025, ankuesja ka dërgon një kërkesë për informacion pranë FSASH nëpërmjet të cilës ka kërkuar informacion mbi transparencën e shpenzimeve të organizatës për 5 vitet e fundit. Ankuesja nuk ka marrë një përgjigje zyrtare në lidhje me këtë kërkesë. FSASH, prapësoi se, ankuesja për transparencën financiare, nuk paraqet asnjë provë, apo fakt për abuzim nga anëtarët e Kryesisë me to dhe se ajo aludon, hamendëson për akuza pa baza. Sipas FSASH, ankuesja është dëgjuar me shumë vëmendje për problemin e transparencës financiare të FSASH dhe është sqaruar për problemin në disa raste dhe me anë të një komunikimi zyrtar në grupin zyrtar të *ehatsapp*-it dhe se në momentin e paraqitjes së kërkesës për informacion stafi drejtues i FSASH, edhe financjerja gjithashtu, ishin të rinj.

Në vijim të një një mesazhi në grupin *ehatsapp* të Këshillit Drejtues të FSASH, pas një mesazhi të Sekretarit Organizativ, në lidhje me dorëheqjen nga pozicioni të Kryetarit të Nderi të FSASH, ankuesja në datën 21.2.2025 shkruan: "*Sa i shtirur ky mesazh. Një pyetje kam unë. Cili prej jush është prekur më shumë? Të paktën njëherë tregohuni të vërtetë ndoshta edhe me veten tuaj. Sepse gjatë këtyre viteve kam parë që respektin e keni pasur dhe e keni sipas interesit*"

Në datën 4.3.2025, në grupin *ehatsapp* të Këshillit Drejtues të FSASH, nga ana e Sekretarit Organizativ është hedhur njoftimi, për ngritjen e Grupit të Punës për Kontroll dhe Ndihmë nëpër Seksionet Sindikale të NJVA. Qëllimi i kontrollit do të ishte ndër të tjera, zbatimi dhe realizimi i detyrave të vendosura nga Kongresi i 9 i FSASH, puna e bërë nga çdo Seksion, puna e bërë në lidhje me shtimin e numrit të anëtarëve, puna e bërë për ofrimin e shërbimeve sindikalistëve (siguracioni i makinës, shpërndarja e Kartave B. (për karburantin), certifikata me ½ e çmimit), përgatitja e planit të punës të përmuajshëm, takimet e punës me ZVA dhe problemet e trajtuara, shfrytëzimi i kohës së punës, vënë në dispozicion de shërbim të sindikatës. Në njoftim evidentohet se, kontrolli dhe ndihma ndaj Seksioneve Sindikale nga grupi i punës rrjedh ndër të tjera nga detyrimi për zbatimin me rigorozitet i nenit 6, pika 6.12 të Statutit ku parashikohet: "*KD mund të marrë masa disiplinore deri në përjashtim nga radhët e veta edhe për anëtarë të tij, kur ata i kundërvihen statutit, normave dhe parimeve mbi të cilat është ndërtuar dhe funksionon FSASH, kur ata përpiqen të denigrojnë reputacionin dhe arrijtet historike të FSASH, shkelin Kodin e Etikës, etj. Në këto raste merret për bazë edhe gjykimi i Komisionit të Garancive Statuore dhe Etikës.*"

Në vijim, në datën 20.3.2025, ankuesja shkruan: "*Përshëndetje të gjithëve! Por në veçanti, ty z. B. për faktin sepse po shikoj që kërkon të kemi zbatueshmëri, por harron që këto nisi nga vetja duke ditur: 1) funksionin tënd; 2) për këto pikat e statutit të cilat nuk janë vetëm për ne por janë dhe për ju; 3) kontrolli dhe ligjshmëria besoj është e njëjte, sepse edhe për ju kryetar+kryesi ka institucione më të larta të cilave mund t'u drejtohem. Z. Kryetar Sh. B ju kam dërguar një kërkesë të cilën e bëra të ditur edhe në mbledhjen e kryesisë për të cilën më the të kthej përgjigje, nga nëntori e në vazhdim. Jam në pritje, nuk kam harruar. Sepse transparencën e kishe dhe në plan të parë tek programi i prezantuar dhe nuk është hedhur mënyra e pagesës për secilin prej nesh dhe përse është bërë çdo*

pagesë apo çfarë kemi bërë për të marrë pagesa ekstra. z.S, besoj për ato që shkruan B., është detyra jote. Prandaj një lutje, mos ndërhyjni dhe mos kapërceni funksionet tuaja.”

Rezulton se në datën 14.04.2025, (nr. 2413 prot) ankuesja ka paraqitur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) një ankesë për zbatim të gabuar të legjislacionit arsimor nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier (DRAP Fier). Objekt i kësaj anekese ka qenë problematika e dy mësuesve që i përkasin Seksionit Sindikal Selenicë. Ankuesja në ankesën e saj drejtuar MAS, pretendon se ZVAP Vlorë dhe DRAP Fier kanë interpretuar gabim ligjin për dy mësuesit, në lidhje me procedurën e licensimit të tyre. Me shkresën nr. 2413/1 prot., datë 25.04.2025, MAS e ka përcjellë ankesën për trajtim pranë DRAP Fier dhe njëkohësisht ka vendosur në dijëni FSASH.

Në lidhje me problematikën e licensimit të dy mësuesve, për të cilët ankuesja kishte paraqitur ankesën në MAS, në datën 24.4.2025, ankuesja në grupin *ehatsapp* ka shkruar mesazhin me këtë përmbajtje: *“Para disa ditësh na hidhet njoftimi për takim të kryetarit të FSASH-it dhe kryetarit të SPASH-it me përfaqësues të MAS-it. Megjithatë ankesën e bëra me mbështetjen e mësuesve të cilët ishin dakort duke u nisur nga ky sms i ndalova të bënin pagesën. Ata më respektuar por zyra i mori në telefon dhe u tha, bëni pagesën sepse mbaron afati. Ata e bënë pagën dhe unë në sytë e tyre dola jokorrekte. Por, personat përgjegjës, apo kompetentët në ministri, të cilët nuk e vazhduan ta ndiqnin problematikën edhe pas takimit, do mbajnë përgjegjësi sepse, një problematike i shkoj deri në fund. Kam vërtetuar që ndryshe thonë në përballje dhe ndryshe në mënyrë institucionale. Për këtë po u hedh dy dokumenta të ndryshëm njëri që është drg në DRAP dhe një në grupin tonë. Vërtet mund të bëni bashkëpunime por ato duhet të kenë peshë, sepse janë në letra më shumë sesa në realitet.”*

Rezulton se në datën 28.04.2025, Grupi i Punës për Kontroll dhe Ndihmë, ka zhvilluar takimin në Seksionin Sindikal Selenicë. Gjatë këtij takimi është mbajtur edhe axhenda e kontrollit në këtë seksion sindikal. Pikat që janë kontrolluar janë: *Nënshkrimi i kontratës së punës me bashkinë*, e cila është realizuar; *Bashkëpunimi me ZVA, DRAP etj*, ku relatohet se është trajtuar çështja e transportit, leja e zakonshme, pagesa e oreve suplementare; *Masat për dërgimin nëpër IA të shkresës së MAS dhe E.T për Sindikatat FSASH\SPASH*, e cila shënohet e realizuar; *Informacion për raste të hyrjes nëpër IA të Sindikatave të tjera që nuk janë partnere të MAS*, informohet se nuk ka patur; *Përgatitja e Planeve të punës*, shënohet se janë dorëzuar; *Dokumentacioni që vërteton ditët e punës për FSASH*, relatohet se disponohen të gjitha; *Përputhet Plani mujor me dokumentacionin që mban për të vërtetuar ditët e punës në Federatë*, përgjigja është: me të gjitha format e duhura ligjore; *Si e përdor 20% që merr nga Federata për llogari të Sek.Sindikal? A e pasqyron atë me dokumentacion*, është përgjigjur: pyet financën; *Puna e bërë për ofrimin e shërbimeve ndaj antarëve sindikalistë (Bolv, Eurosig, certifikata)*, informohet se këto shërbime nuk i ka pranuar asnjë anëtar; *Realizimi i objektivave të Kongresit të 9 të FSASH ((a) Sa mësues ka gjithsej ZVA b) Sa nga këta janë dhe antarë të FSASH c) Sa ka antarësime të reja?)*, janë plotësuar të dhënat respektive.

Në qëndrimin e saj FSASH, pretendon se, të dhënat në lidhje me numrin e antarëve nuk janë të sakta, se nga ankuesja nuk disponohet dokumentacioni në lidhje me ditët e punës në FSASH dhe se

informacioni financiar duhet të disponohet nga ankuesja dhe se ajo nuk dispononte asnjë dokument. Megjithatë, referuar dokumentit të kontrollit të zhvilluar në datën 28.4.2025, ky dokument rezulton se është nënshkruar nga ankuesja si Kryetare e Seksionit Sindikal dhe Kryetari i FSASH, pa kundërshtime ose rezerva.

Sipas vendimit nr.1, datë 30.4.2025, të Kryetarit të FSASH (kopja e dorëzuar pranë Komisionerit nuk është e firmosur), është thirrur një mbledhje online e Kryesisë së Federatës në datën 2.5.2025, me rend dite: *“1. Paraqitja e pasqyrës së kontrolleve të kryera në disa Seksione dhe shqyrtimi i veprimeve të nevojshme. 2. Diskutimi i situatës së krijuar në Seksionin Selenicë, në lidhje me znj.E. D , Kryetare Seksioni, dhe përcaktimi i hapave institucionalë për zgjidhjen e problemit.....”*

Në datën 01.05.2025, në grupin *ehatsapp* të Këshillit Drejtues të FSASH, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të FSASH, ankueses i është komunikuar se me vendim unanim të Kryesisë së FASH, të mbajtur *online*, ndaj ankueses ishte marrë masa disiplinore “vërejtje” me motivacionin për sjellje të papërshtatshme dhe shkelje të etikës në komunikim publik.

Nga aktet e administruara, sipas procesverbalit datë 01.05.2025, të mbajtur nga B.S, i cili mban pozicionin e Sekretarit Organizativ, relatohet se në mbledhjen e thirrur urgjent jashtë radhe, të zhvilluar *online*, është vendosur, që të mbyllet grupi *ehatsapp* i Këshillit Drejtues dhe ti jepet vërejtje znj.E. D për shkelje në mënyrë të vazhdueshme të Statutit të Federatës dhe Etikës. Për zhvillimin e mbledhjes *online*, nuk u depozituan prova të tjera që provon zhvillimin e saj, përveç procesverbalit të sipërcituar.

Ankuesja ka paraqitur një ankesë lidhur me masën disiplinore, nëpërmjet ankesës që mban datën 03.05.2025. Në përgjigje të kësaj ankese, me shkresën nr.50 prot., datë 19.05.2025, FSASH i ka kthyer përgjigje ankueses duke parashtruar: *“...për çështjet që ju referoni janë ndjekur procedurat e parashikuara nga Statuti dhe Kontrata Kolektive e Punës. Të gjitha vendimarrjet janë kryer në përputhje dhe në respekt të përgjegjësive përkatëse. Lidhur me këto procedura do të njoftoheni zyrtarisht në vazhimesi nëpërmjet strukturave statutoire të FSASH....”*Ankuesja pretendon se ka marrë dijeni për këtë shkresë në datën 05.06.2025.

Me vendimin datë 2.5.2025, të Kryesisë së FSASH është vendosur: *“Pas shqyrtimit të sjelljes jo etike të konstatuar në komunikimet përmes grupit ehatsapp, të Këshillit Drejtues, si dhe qëndrimeve fyese, etiketuese dhe denigruese ndaj anëtarëve të FSASH nga znj.E. D , aktualisht kryetare e Seksionit Sindikal Selenicë, Vlorë, Kryesia e FSASH, në përputhje me parimet statutoire të organizatës, vendosi “1. Sjellja dhe veprimet e znj.E. D të kalojnë për shqyrtim dhe vlerësim pranë Komisionit të Garancive Statutoire dhe Etikës (KGSE).2. Sjellja arrogante dhe kundërshtimi i bashkëpunimit me Grupin e Kontrollit të ngritur me Vendim kryesie nga znj.D.T të kalojnë për shqyrtim dhe vlerësim pranë Komisionit të Garancive Statutoire dhe Etikës (KGSE). Sekretari i Përgjithshëm i federatës ngarkohet të përgatisë praktikën përkatëse dhe ta dorëzojë pranë Komisionit të Garancive Statutoire dhe Etikës (KGSE) brenda 10 ditëve punë nga data e këtij vendimi.....”*

Referuar protokollit të mbajtur për mbledhjen e zhvilluar *online*, të Kryesisë së FSASH, rezulton se është trajtuar çështja e ankueses dhe mbyllja e grupit *ehatsapp*.: “...Kryetari foli për çështjen e grupit *ehatsapp* dhe pse u mbyll. Askush nuk na sjell këtu me zor, të gjithë jemi këtu vullnetarisht. Zonja i kundërvihet çdo postimi nga krerët, askush nuk duhet ta nxijë punën. Me ardhjen e kryesisë e cila është më e mira e mundshme.....Znj.E. na hap probleme prej 7 muajsh. Ne jemi në pozita të shëndosha pune si asnjëherë më para dhe ajo anatemon cdo gjë....” Në përfundim të mbledhjes është vendosur që çështja e ankueses të shkojë në KGSE.

Në datën 19.5.2025, rezulton se është mbledhur KGSE, për diskutim dhe analizim mbi bazën e statutit të FSASH, të disa Kryetarëve të Seksioneve Sindikale. KGSE ka marrë në shqyrtim materialet e vendosura në dispozicion nga Sekretari i Përgjithshëm. Në vendimin e datës 19.05.2025, të KGSE parashtrohet:

“Znj. E. D, ka shkelur Statutin e Federatës konkretisht:

Neni 4, pika 4.8b dhe neni 4, pika 8, nënpika b: të zbatojë vendimet e organizatës sindikale ky bën pjesë, të Këshillit Sindikal dhe Seksionit të Njesisë Vendore, si dhe të organeve më të larta të FSASH.

Neni 6, pika 6.14 : KD mund të marrë masa disiplinore deri në përjashtim nga radhët e veta edhe për anëtarë të tij, kur ata i kundërvihen statutit, normave dhe parimeve mbi të cilat është ndërtuar dhe funksionon FSASH, kur ata përpiqen të denigrojnë reputacionin dhe arritjet historike të FSASH, shkelin Kodin e Etikës, etj. Në këto raste merret për bazë edhe gjykimi i Komisionit të Garancive Statutore dhe Etikës. Gjykime dhe gjendërimë të tilla janë në kompetencë edhe të seksioneve dhe këshillave sindikale për anëtarët e tyre. Për seksionet dhe këshillat sindikalë, vendimi përfundimtar merret nga Kryesia e FSASH.

Dhe neni 8 : Kryesia e FSASH është organ kolegjal që, midis dy mbledhjeve të Këshillit Drejtues, organizon dhe drejton veprimtarinë e Federatës. Kryesia përbëhet nga Kryetari i FSASH, Kryetari i Nderit, Sekretari i Përgjithshëm, Nën/Kryetarët, dhe pesë anëtarë nga kryetarët e seksioneve sindikale duke zbatuar kriteret e numrit të anëtarëve dhe shpërndarjes gjeografike. Kryesia e FSASH i merr vendimet me shumicë të thjeshtë të votash. Në rast barazimi, fiton varianti për të cilin voton Kryetari i FSASH.

Statuti, znj.D. , në mënyrë të vazhdueshme e ka përdorur faqen e Grupit të Këshillit Drejtues, duke hedhur staturë dezinformuese dhe destabilizuese, duke shpërndarë të dhëna jo të sakta, keqdashëse, kërcënuese duke akuzuar deri në drejtues të Seksioneve Sindikale të tjera, me lloj lloj akuzash.

Për të gjitha shkeljet statutore, Kodit të Etikës dhe Kontratës Kolektive të Punës, mendojmë se:

Znj.E.D. të propozohet Këshilli Drejtues për përjashtim nga radhët e saj.”

Ankuesja nuk është njoftur për procedurën e zhvilluar dhe vendimin e datës 19.5.2025 të KGSE.

Në datën 30.05.2025, ankuesja ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi pranë Komisionerit duke pretenduar se është diskriminuar nga ana e FSASH, për shkak të *bindjeve filozofike* dhe për shkak të *“problematikave që ka ngritur, informacionet që ka kërkuar mbi të drejtat e mësuesve dhe llogaridhënien për veprimtarinë e organizatës”*.

Në datën 25.06.2025, ankuesja është njoftuar nëpërmjet komunikimit në *ëhatsapp*, se në datën 27.06.2025 duhet të paraqitet në selinë qendrore të Sindikatës, në kuadër të procedurës së ndjekur nga Komisioni i Garancive Statutore dhe Etikës (KGSE). Në këtë njoftim parashtohet se, gjatë takimit ankuesja do të njihet me masën e marrë nga KGSE dhe do t’i jepej mundësia që të paraqesë qëndrimet dhe argumentat në lidhje me çështjen.

Rezulton se ankuesja ka marrë pjesë në takimin e zhvilluar në datën 27.06.2025, të zhvilluar pranë KGSE. Ankuesja pretendon se, gjatë këtij takimi është përballur me akuza të pavërteta dhe se në përfundim të takimit nuk i është dhënë kopje e dokumentacionit. Nga aktet e administruara rezulton se gjatë takimit është mbajtur procesverbali datë 27.06.2025, i cili është nënshkruar vetëm nga anëtarët e KGSE. Ankueses nuk i është vendosur në dispozicion para ose gjatë takimit kopje e dokumentacionit mbi bazën e të cilit po zhvillohej procedura disiplinore në ngarkim të saj. Në procesverbalin e datës 27.6.2025, pasqyrohet se: *“E. D kërkon dokumentacionin. Sekretari i Përgjithshëm i përgjigjet se do t’i vihet në dispozicion në një moment të dytë.”*

Në datën 4.7.2024, është zhvilluar mbledhja e Këshillit Drejtues të FSASH, bazuar në vendimin e datës 2.7.2025 të Kryetarit të FSASH. Ndër të tjera në takimin e datës 4.7.2025, është diskutuar edhe në lidhje me procedurën në ngarkim të ankueses. Rezulton se ankuesja ka marrë pjesë në këtë takimin e datës 4.7.2025.

Referuar procesverbalit të mbajtur gjatë takimit të datës 4.7.2025 të Këshillit Drejtues të FSASH, i cili rezulton të jetë nënshkruar vetëm nga personi që e ka mbajtur, pasqyrohet se nga ana e ankueses janë bërë këto deklarime: *“Kam patur kontakte me ZVA dhe nuk më ka shprehur askush vërejtje në lidhje me punën time dhe me personin tim. Grupi i KGSE më kanë ofenduar në lidhje me atë që unë përfaqësoj. Shpreh pakënaqësitë e mia në lidhje me sjelljen time nga KGSE.”*Në përfundim të mbledhjes së datës 4.7.2025, Këshilli Drejtues ka vendosur të miratojë vendimin e KGSE.

Me vendimin nr.130 prot, datë 4.7.2025, të Këshillit Drejtues të FSASH, është vendosur: *“1. Pushimi i znj.E. D si Kryetare e Seksionit Sinidkal, Selenicë. 2. Përrjashtimin e znj.E. D nga radhët e KD.”*. Në këtë vendim arsyetohet si vijon:

“Zonja D. në mënyrë të vazhdueshme ka shkelur detyrimet kryesore në zbatim të vendimeve të organeve më të larta të FSASH, (neni 4, pika 4.8, pika b)

Ka shkelur nenin 8, pika 8.4, duke kundërshtuar në mënyra të ndryshme dhënien e ndihmës së nevojshme të Seksionit Sindikal Selenicë për çështje metodike organizative, ndihme dhe kontrolli (Shih raportin e përgatitur nga Grupi i Kontrollit dhe i ndihmës me datë 28.4.2025)

Znj.D. streson Institucionin e punëdhënësit në të gjithë hierarkinë e tij me letra, duke kërkuar zgjidhjen e problemeve në mënyrë antiligjore. (Rasti i licensimit). Tejkalon kompoetencat, duke anashkaluar strukturat qëndrore të Federatës.

Në mënyrë të vazhdueshme ka përdorur Grupin Zyrtar të ehatsapp të KD, duke hedhur statuse desinformuese dhe destabilinuese, duke shpërndarë të dhëna jo të sakta keqdashëse, kërcënuese duke akuzuar edhe Drejtues të Seksioneve Sindikale të tjera me lloj, lloj akuzash.

Për veprimet dhe mosveprimet e kryera nga znj.D. , KGSE e mbledhur për herë të dytë në datën 27.06.2025, ka thirrur përsëri për dëgjuesë znj.D. për të dhënë shpjegime në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e kryera prej saj në kundërshtim me Statutin e Sindikatës. Në mbledhjen e KD, znj.D. solli argumenta dhe kundërargumenta për ti hedhur poshtë ato.”

Vlerësimi i Komisionerit.

Nga tërësia e akteve të administruara konstatohet se, masa disiplinore “vërejtje” e dhënë ndaj ankuses në datën 01.05.2025, nga Kryesia e FSASH, është e pabazuar në Statut. Referuar nenit 8, të Statutit të FSASH, dispozitë mbi bazën e të cilës rregullohet funksionimi i Kryesisë së Federatës, nuk parashikohet që Kryesia e FSASH ka kompetencën për dhënien e masave disiplinore. Një kompetencë e FSASH për dhënien e masave disiplinore nuk rezulton nga asnjë dispozitë tjetër e Statutit.

Krijimi dhe funksionimi i Komisionit të Garancive Statutore dhe Etikës (KGSE) , rregullohet nga neni 15, i Statutit, ku parashikohet:

“15.1. KGSE është organ që shqyrton dhe vendos për çështjet që lidhen me zbatimin dhe interpretimin e statutit, të vendimeve dhe rregulloreve të forumeve qëndrore, si dhe respektimin e normave etike në veprimtarinë e FSASH. Procedura e zgjedhjes përcaktohet nga Këshilli Drejtues i FSASH.

15.2. KGSE përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Anëtarët, në momentin e zgjedhjes, duhet të kenë të paktën 10 vjet anëtarësi dhe nuk mund të jenë anëtarë të forumeve të tjera qëndrore të sindikatës, as anëtarë të administratës.

15.3. Mandati i anëtarëve të KGSE – së është 7 vjeçar.

15.4. KGSE në mbledhjen e parë zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarin

15.5. KGSE vihet në lëvizje në bazë të kërkesave të anëtarëve, strukturave apo forumeve qëndrore të FSASH. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë 2/3 e anëtarëve të tij. Vendimet merren me votim të hapur, me shumicë të thjeshtë dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar.

15.6. KGSE nuk mund të shyrtojë e të gjykojë vendimet e Kongresit dhe të Këshillit Drejtues të FSASH.

15.7. Ngritja dhe funksionimi i KGSE përcaktohet me rregullore të veçantë të Këshillit Drejtues.”

Gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk rezultoi që të jetë miratuar rregullorja për ngritjen dhe funksionimin e KGSE, sipas nenit 15, pika 15.7 të Statutit.

KGSE, e vënë në lëvizje me kërkesë të Kryesisë së FSASH ka marrë vendimin e datës 19.05.2025, për t'i propozuar Këshillit Drejtues përjashtimin e ankueses nga radhët e tij, duke u bazuar në mënyrë të njëanshme vetëm në materialet e paraqitura nga Sekretari i Përgjithshëm. Në mbledhjen e datës 19.5.2025 të KGSE kanë marrë pjesë Sekretari i Përgjithshëm dhe Sekretari Organizativ, të cilët janë dy prej drejtuesve ndaj të cilëve pretendohet se ankuesja ka shkelur etikën në komunikim. Kryetari i KGSE është gjithashtu një nga drejtuesit ndaj të cilëve pretendohen se ka patur komunikim jo etik nga ana e ankueses. Ankuesja nuk është njoftuar për procedurën e zhvilluar nga KGSE, nuk është dëgjuar, nuk është njohur shkeljet e pretenduara në ngarkim të saj dhe nuk i është dhënë mundësia që të mbrohet dhe të paraqesë prova në mbrojtje të saj. Procedura dhe vendimi i datës 19.5.2025 i KGSE është marrë në mungesë të plotë të palës ankuese

Komisioneri vlerëson se, vendimi i datës 19.5.2025, i KGSE, nëpërmjet të cilit është vendosur që t'i propozohet Këshillit Drejtues të FSASH përjashtimi i ankueses nga radhët e Këshillit Drejtues, është marrë në kundërshtim me të drejtën e ankueses për një proces të rregullt ligjor. Ankuesja nuk është njoftuar, nuk është dëgjuar dhe nuk i është dhënë e drejta për tu mbrojtur në lidhje me pretendimet për shkelje të paraqitura në ngarkim të saj.

Neni 42, pika 2, e Kushtetutës përcakton shprehimisht se: *“2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*

Në jurisprudencën kushtetuese për procesin e rregullt, Gjykata është shprehur se disa standarde kushtetuese janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e standardeve të tjera. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. (shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese)

E drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Në këtë kuptim, çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit me faktet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për proces të rregullt. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia

e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimin të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023, paragrafi 58; nr.67, datë 11.11.2016, paragrafi 12; nr. 30, datë 28.12.2006, paragrafi 6, të GJK-së*).

Në lidhje me takimin e zhvilluar nga KGSE në datën 27.06.2025, për ti dhënë mundësinë ankueses që të paraqesë argumenta në mbrojtje të saj lidhur me vendimin e datës 19.5.2025, Komisioneri vlerëson se, dëgjimi i palës, në rastin konkret të ankueses, duhet të bëhet para se të merret një vendim dhe jo pasi një vendim i tillë është marrë.

Megjithatë edhe mbledhja e datës 27.06.2025, nuk i ka krijuar ankueses mundësi efektive për të mbrojtur interesat e saj. Ankuesja është njoftuar për të marrë pjesë në këtë takim por nuk i është vendosur në dispozicion as vendimi i datës 19.5.2025 dhe as dokumentacioni mbi bazën e të cilit është marrë një vendim i tillë.

E drejta për t'u dëgjuar, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr.7, datë 12.03.2010, paragrafi 4; nr.12, datë 06.06.2005, paragrafi 7, të GJK-së*). Njohja paraprake e personit me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt si një e drejtë themelore (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021, paragrafi 34, të GJK-së*).

Vendimi Nr.130 prot., datë 4.7.2025, i Këshillit Drejtues të FSASH bazohet në nenin 6, pika 6.14, ku parashikohet: *“6.14 KD mund të marrë masa disiplinore deri në përjashtim nga radhët e veta edhe për anëtarë të tij, kur ata i kundërvihen statutit, normave dhe parimeve mbi të cilat është ndërtuar dhe funksionon FSASH, kur ata përpiqen të denigrojnë reputacionin dhe arritjet historike të FSASH, shkelin Kodin e Etikës, etj. Në këto raste merret për bazë edhe gjykimi i Komisionit të Garancive Statutore dhe Etikës.”*

Në radhë të parë, sikurse më sipër rezulton ky vendim është bazuar në vendimin e datës 19.5.2025 të KGSE, i cili është marrë në kundërshtim me të drejtën e ankueses për një proces të rregullt ligjor.

Gjatë mbledhjes së Këshillit Drejtues të datës 4.7.2025, ku ankuesja rezulton që të ketë marrë pjesë, ajo sërisht nuk është njohur me aktet dhe dokumentacionin në ngarkim të saj. Pavarësisht prezencës së saj fizike në mbledhjen e datës 4.7.2025, ankueses nuk i janë krijuar kushtet për tu njohur efektivisht me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi.

Sa i takon shkeljeve në ngarkim të ankueses, nga aktet e administruara rezulton se:

Në lidhje me shkeljen e nenit 4, pika 4.8, germa b, të Statutit ku përcaktohet : “4.8. I anëtarësuarit në FSASH ka këto detyrime kryesore: b) të zbatojë vendimet e organizatës sindikale ku bën pjesë, të këshillit sindikal dhe seksionit të njësisë vendore, si dhe të organeve më të larta të FSASH”, në vendim nuk përcaktohet se cilat janë vendimet që ankuesja nuk ka zbatuar.

Në lidhje me shkeljen e nenit 8 pika 8.4, të Statutit ku përcaktohet: “Kryesia e FSASH ka kompetencë dhe përgjegjësit për: “8.4. Dhënien e ndihmës së nevojshme këshillave dhe seksioneve sindikale për çeshtje metodike, organizative, juridike, etj.”, në radhë të parë Komisioneri vlerëson se kjo është një nga përgjegjësitë e Kryesisë dhe jo të Seksionit Sindikal. Në radhë të dytë, referuar raportit të datës 28.4.2025, të administruar nuk rezulton që të jenë evidentuar shkelje nga ana e ankueses.

Sa i takon shkeljes që lidhet me stresin e shkaktuar ndaj institucionit të punëdhënësit, duke kërkuar zgjidhjen e problemeve në mënyrë antiligjore, Komisioneri vlerëson se paraqitja e ankesës nga ana e ankueses pranë MAS por edhe ndjekja e problematikës së mësueve që i përkasin seksionit sindikal të drejtuar nga ankuesja nuk mund të përbëjë shkelje. FSASH nuk shpjegon se përse nëpërmjet ndjekjes së kësaj problematike për mësuesit anëtarë të seksionit të saj sindikal ankuesja ka tejkalluar kompetencat duke anashkalluar strukturat qendrore të Federatës

Referuar komunikimeve të ankueses në grupin *ehatsapp* të Këshillit Drejtues të FSASH, në radhë të parë ato janë komunikime të brendshme të oraagnizatës. Në radhë të dytë, referuar përmbajtjes së këtyre, konstatohet se qëndrimet e ndryshme dhe kritikuese të ankueses nuk drejtohen ndaj arritjeve apo reputacionit të FSASH si organizatë por i referohen, sipas rastit, veprimeve dhe mosveprimeve ose nismave të ndërmara nga drejtuesit aktual të FSASH, për të cilat ankuesja nuk ndan të njëjtat qëndrime dhe nëpërmjet komunikimit në grupin *ehatsapp* të Këshillit Drejtues shpreh qëndrimet dhe kritikën e saj.

Bazuar në nenin 3, të Statutit të FSASH, ku përcaktohen parimet e përgjithshme të veprimtarisë së FSASH, parashikohet:

“Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës e zhvillon gjithë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Statuti, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet e tjera të shtetit shqiptar, duke zbatuar këto parime të përgjithshme:

- 3.1. FSASH gjithë jetën dhe veprimtarinë e saj e zhvillon në mënyrë të pavarur nga Shteti, administrata shtetërore, nga partitë politike si dhe nga çdo grupim tjetër ideologjik apo fetar.*
- 3.2. FSASH zbaton normat e demokracisë së brendshme për zgjedhjen e organeve dhe drejtuesve të saj, për përcaktimin e politikës sindikale, të qëllimeve dhe objektivave, për funksionimin, drejtimin dhe administrimin e saj.*
- 3.3. FSASH nuk dikton në veprimtarinë e brendshme sindikale të seksioneve, këshillave apo organizatave sindikale. Ajo respekton pavarësinë dhe vullnetin e tyre, pluralizmin e mendimeve*

e të alternativave dhe pranon e mbështet vendimet e çdo strukture sindikale në përbreje të saj, me kusht që ato të jenë në përputhje me parimet dhe normat e këtij Statuti.”

Ndërsa FSASH pretendon se ankuesja nëpërmjet komunikimeve në *whatsapp* ka shkelur Kodin e Etikës, gjatë shqyrtimit nuk u administrua kopje e këtij Kodi. Gjatë shqyrtimit FSASH nuk depozitoi kopje të Kodit të Etikës, akt i cili pretendohet se është shkelur.

Nëpërmjet vendimit nr.130 prot, datë 4.7.2025, Këshilli Drejtues i FSASH jo vetëm që ka përjashtuar ankuesen nga radhët e tij por edhe e ka larguar atë nga funksioni si Kryetare e Seksionit Sindikal Selenicë. Referuar nenit 16, pika 16.4 të Statutit mbi bazën e të cilit është marrë vendimi i Këshillit Drejtues, nuk rezulton që ky i funit të ketë të drejtën që të largojë nga detyra Kryetarin e seksionit sindikal, i cili në referim të nenit 13, pika 13.3, zgjidhet me votim të fshehtë nga Seksioni Sindikal.

Sa më sipër, si dhe bazuar në faktet, rrethanat dhe provat e administruara, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja E. D , i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, në lidhje me dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” në datën 01.0.2025, si edhe gjatë procesit disiplinor të finalizuar me vendimin vendimin nr.130 prot., datë 4.7.2025, të Këshillit Drejtues të FSASH, nëpërmjet të cilit ankuesja është larguar nga pozicioni si Kryetare e Seksionit Sindikal Selenicë dhe njëkohësisht si anëtare e Këshillit Drejtues.

B. Shkaku i mbrojtur.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të LMD si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm, përbën diskriminim dhe gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas LMD.

Në lidhje me shkakun/shkaqet e pretenduara të diskriminimit, në radhë të parë duhet që shkakun i pretenduar i diskriminimit të jetë një shkak për të cilin ligji garanton mbrojtje dhe në radhë të dytë duhet të provohet se ankuesi e mbart këtë shkak.

Në formularin e ankesës së paraqitur pranë Komisionerit ankuesja ka identifikuar si shkak të pretenduar diskriminimi “bindjet filozofike”, ndërsa në parashtrimet e saj, ajo pretendon se pretendon se *"është atakuar për problematikat që ka ngritur apo informacionet që ka kërkuar mbi të drejtat e mësuesve, llogaridhënien për veprimtarinë e organizatës"*

Komisioneri konstaton se, neni 1, i LMD, parashikon shprehimisht si shkak të mbrojtur bindjen filozofike. Në lidhje me këtë shkak ankuesja nuk shpjegon se ku konsiston konkretisht ky pretendim i saj dhe se cilat janë këto bindje. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankueses në lidhje me shkakun e pretenduar të bindjeve filozofike nuk është i bazuar.

Neni 1, LMD, liston shprehimisht disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes për “çdo shkak tjetër”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “çdo shkak tjetër” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit “çdo shkak tjetër” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “shkakun” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”.

LMD, por edhe legjislacioni ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, nuk ka parashikime ose përkufizim se çfarë është shkak i mbrojtur. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferencë të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.³

Bazuar në pretendimet e parashtruara nga pala ankuese në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, konstatohet se, ankuesja pretendon se është atakuar për problematikat që ka ngritur, informacionet që ka kërkuar mbi të drejtat e mësuesve dhe llogaridhënien që ka kërkuar për veprimtarinë e organizatës.

Në praktikën e tij, Komisioneri ka vlerësuar se, *konstatimi i problematikave apo mbajtja e qëndrimeve kritike të shprehura për shkak të detyrës/profesionit, si dhe denoncimi i situatave në shkelje të ligjit, të bëra për shkak të detyrës, janë shkaqe të mbrojtura sipas LMD, në kuadër të “çdo shkak tjetër”*.⁴

Nga aktet e administruara rezulton e provuar se, ankuesja “ka kritikuar dhe ka paraqitur problematika në lidhje me mënyrën e drejtimit të organizatës nga ana e organeve drejtuese”. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, diferencë në trajtim dhe trajtimi i disfavorshëm që bazohet në faktin se ankuesja “ka kritikuar dhe ka paraqitur problematika në lidhje me mënyrën e drejtimit të organizatës nga ana e organeve drejtuese”, gëzon mbrojtje në kuadër të parashikimit “çdo shkak tjetër”, në kuptim të nenit 1, të LMD dhe se, bazuar në provat dhe aktet e administruara, rezultoi e provuar se ankuesja e mbart këtë shkak të mbrojtur.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

C.1 Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm të palës ankuese me shkakun e mbrojtur.

³ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të Tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

⁴ Shiko vendimet: nr. 151, datë 11.8.2021, nr. 113, datë 26.08.2019 dhe nr. 128, datë 12 .07. 2023, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Neni 18, i Kushtetutës, sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përcaktuar se: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”.*

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 50 të Kushtetutës, i cili sanksionon lirinë sindikale: *“ Të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës.”*

Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke sanksionuar: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përlligjjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo

kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (*Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁵. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁶. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”⁷

Sipas nenit 10, të Kodit të Punës, liria sindikale mbrohet me ligj.

Parimi i mosdiskriminimit, përshkon në frymë dhe në nene Kodin e Punës, i cili në pikën 1, të nenit 9, të tij ka përcaktuar se: “*Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohej çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi*”. Sipas pikës 2, të nenit 9, të Kodit të Punës, garantohet mbrojtja nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh, sipas formulimit: “*2. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.*”

Bazuar në nenin 9, pika 5, germa ç, të Kodit të Punës, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet ndër të tjera në lidhje me, anëtarësimin dhe aktivizimin në organizata sindikale dhe organizata të punëdhënësve, ose

⁵ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fabián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁶ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

⁷ Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

ndonjë organizatë, anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, duke përfshirë përfitimet e siguruar nga këto organizata.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme⁸.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

LMD parashikon dhe jep përkufizimin e disa formave nëpërmjet të cilave shfaqet diskriminimi. Referuar nenit 3, pikat 2 të LMD, përcaktohet se: *“2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”*

Në bazë të LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : *“7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”*

⁸ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit në punësim dhe profesion e bën edhe Kodi i Punës, duke sanksionuar në nenin 9, pika 10, të tij se: “10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”, si dhe Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82, pika 2, si vijon : “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëherë nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin⁹.

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim.

GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër,

⁹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara.”¹⁰ Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t’i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ shprehet se: “..... niveli i bindjes së nevojshme për arritjen e një përfundimi të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndaren e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën në rrezik.”¹¹

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ka mbajtur qendrimin se: “...aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë *prima facie* ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi.”

Bazuar në përkufizimin që bën ligji për diskriminimin e drejtëpërdrejtë si një nga format e shfaqjes së sjelljeve diskriminuese, elementët kryesorë ose kyç që duhen vërtetuar janë si më poshtë:

- (i) pala ankuese është trajtuar në mënyrë të të padrejtë dhe të pafavorshme në krahasim me mënyrën se si trajtohen, janë trajtuar apo do të trajtoheshin të tjerët, në një situatë të ngjashme;
- (ii) shkaku i pretenduar i diskriminimit nga pala ankuese është një “shkak i mbrojtur” sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;
- (iii) dhe arsyeja për këtë është shkaku i pretenduar i diskriminimit.

¹⁰ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

¹¹ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standardin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se, pala ankuese është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, në lidhje me dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” në datën 1.5.20225, si gjatë procesit disiplinor të finalizuar me vendimin nr.130 prot., datë 4.7.2025, të Këshillit Drejtues të FSASH, nëpërmjet të cilit ankuesja është larguar nga pozicioni si Kryetare e Seksionit Sindikal Selenicë dhe njëkohësisht si anëtare e Këshillit Drejtues. Gjithashtu, rezulton e provuar se, shkaku i pretenduar i diskriminimit fakti që ankuesja “*ka kritikuar dhe ka paraqitur problematika në lidhje me mënyrën e drejtimit të organizatës nga ana e organeve drejtuese*”, gëzon mbrojtje në kuadër të parashikimit “çdo shkak tjetër”, në kuptim të nenit 1, të LMD.

Motivacioni i dhënies së masës disiplinore “vërejtje” të datës 01.05.2025 qartësisht lidhet me qëndrimet kritike dhe problematikat që ankuesja ka bërë në grupin *ehatsapp* të Këshillit Drejtues të FSASH, të cilat janë konsideruar si shkelje të etikës nga ana e saj.

Shkeljet e pretenduara në ngarkim të ankuses për të cilat është marrë vendimi nr.130 prot., datë 4.7.2025, i Këshillit Drejtues të FSASH për largimin e ankuses nga radhët e këtij këshilli si dhe largimin e saj nga pozicioni si Kryetare e Seksionit Sindikal Selenicë, gjithashtu janë ngushtësisht të lidhura me qëndrimet kritike dhe problematikat që ankuesja ka bërë në grupin *ehatsapp* të Këshillit Drejtues të FSASH. Në mbledhjen e Kryesisë së FSASH, kur është trajtuar çështja e ankuses, mbyllja e grupit *ehatsapp* dhe është vendosur që çështja të trajtohet nga KGSE, theksohet se kundërshtimet e bëra nga ankuesja ndaj drejtuesve të organizatës janë vlerësuar si problem.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, rezulton e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm dhe se jemi në kushtet e një prezumimi të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*).

Në këto kushte, mbetet që të vlerësohet nëse për këtë diferencë në trajtim dhe trajtim të diferencuar ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv dhe barra e provës për të provuar se, trajtimi i diferencuar dhe i disfavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja, nuk është diskriminues i takon FSASH. Për këtë, FSASH ka detyrimin që të provojë se trajtimi i diferencuar dhe i disfavorshëm i ankuses është i justifikuar objektivisht, domethënë, trajtimi i diferencuar ndjek një qëllim legjitim ose ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

FSASH, pretendoi se, masat e marra ndaj ankuses ishin të bazuara, pasi ajo me deklaratimet e saj në grupin *ehatsapp* të Këshillit Drejtues ka shkelur etikën dhe se vendimarrja bazohet në nenin 6, pika 6.14, *pasi ankuesja me sjelljen e saj i është kundërvënë statutit, normave dhe parimeve mbi të cilat është*

ndërtuar dhe funksionon FSASH, ka denigruar reputacionin dhe arritjet historike të FSASH dhe ka shkelur Kodin e Etikës.

Kushtetuta e Shqipërisë, garanton më vete të drejtën për lirinë e shprehjes (neni 22).

Liria e shprehjes garantohet edhe nga KEDNJ, ku në nenin 10, të saj, parashikohet:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Komisioneri, sikurse është arsyetuar edhe më sipër në këtë vendim, vlerëson se qëndrimet kritike dhe problematikat e konstatuara nuk drejtohen kundër organizatës së FSASH, por drejtohen dhe shprehin mospajtim me mënyrën e organizimit dhe drejtimit të oragnizatës nga ana e drejtuesve të saj. Qëndrimet e ankueses janë bërë në kuadër të diskutimeve të brendshme të organizatës. Në bazë të nenit 3, të Statutit, FSASH respekton pluralizmin e mendimeve e të alternativave. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se kufizimi i lirisë së shprehjes së ankueses, nëpërmjet masave disiplinore të marra ndaj saj, është i panevojshëm.

Komisioneri vlerëson se, qëllimi i parashikuar nga neni 6, pika 6.14, i Statutit përbën një qëllim të ligjshëm, por bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes konkrete, nuk rezulton që ankuesja *me sjelljen e saj i është kundërvënë statutit, normave dhe parimeve mbi të cilat është ndërtuar dhe funksionon FSASH, ka denigruar reputacionin dhe arritjet historike të FSASH dhe ka shkelur Kodin e Etikës.*

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, FSASH, nuk arriti të provojë që ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e diferencuar dhe të disfavorshëm ndaj të cilit është ekspozuar ankuesja.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja E. D është diskriminuar në ushtrimin e lirisë sindikale, nga ana e FSASH, për shkak se ankuesja *“ka kritikuar dhe ka paraqitur problematika në lidhje me mënyrën e drejtimit të organizatës nga ana e organeve drejtuese”*. Për rrjedhojë, FSASH ka shkelur dispozitat e ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për*

kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, duhet të jetë anulimi i masës disiplinore vërejtje, të marrë nga Kryesia e FSASH në datën 01.05.2025 dhe vendimi nr.130 prot., datë 04.07.2025, i Këshillit Drejtues të FSASH dhe rikthimi i ankueses në pozicionin e mëparshëm si Kryetare e Seksionit Sindikal Selenicë.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e *diskriminimit të drejtpërdrejtë* të ankueses E. D , në ushtrimin e lirisë sindikale, për shkak se “*ka kritikuar dhe ka paraqitur problematika në lidhje me mënyrën e drejtimit të organizatës nga ana e organeve drejtuese*”, nga ana e Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH).
2. Në referim të pikës 1 të vendimit, Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH), të marri masa për:
 - 2.1 Anulimin e masës disiplinore “vërejtje” ndaj ankueses E. D , të marrë nga Kryesia e FSASH në datën 01.05.2025;
 - 2.2 Anulimin e vendimit nr.130 prot., datë 04.07.2025, të Këshillit Drejtues të FSASH, duke e rikthyer ankuesen në pozicionin e mëparshëm si Kryetare e Seksionit Sindikal Selenicë dhe për shkak të këtij pozicioni anëtare e Këshillit Drejtues të FSASH.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH), detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Çdo shkak tjetër
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Diskriminim